



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas /Glllogoc
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-060/01-45300 dt. 13/09/ 2024

Në bazë të nenit dhe nenit 44, pika 44.1, 44.2 dhe 44.3 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, neni 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në bazë të kërkesës së kryetarit të Komunës së Drenasit më datë: **19.9.2024** (E enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

Thërret

Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Propozim vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re.
2. Propozim vendim për Plotësim ndryshimin e Statutit të Komunës së Drenasit lidhur me emërtimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Propozim vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit për shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vjet)
4. Draft strategjia për Zhvillimin dhe fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029.
5. Raporti i punës Janar-Qershor 2024 i Kryetarit dhe qeverisjes lokale.
6. Raporti financiar Janar-Qershor 2024.
7. Diskutim i Raportit i Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për vitin 2023.
8. Diskutim i Planit të Veprimit për Implementimin e Rekomandimeve të ZKA-së
9. Raporti i punës së KKS-së Janar-Qershor.
10. Propozim vendim i Buxhetit të komunës për vitet 2025 dhe parashikimi i buxhetit për vitin 2026-2027.
11. Raporti i performancës komunale për vitin 2023 për komunën e Glllogocit.
12. Propozim vendim për transfer/harmonizim në kategorinë e pagave.
13. Propozim vendim për ndryshimin e emrit të projekteve.



Kryetari i Komunës së Drenasit
[Signature]
Ramiz Lladrovci

Drenas, më 13.9.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas(Gllogoc)
Zyra e Kryetarit



Nr.01- 400/01-45495, dt. 13/09/.2024

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe kërkesës për ndarje nr.06-070/01-22711 të dt.13.05.2024, që Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2024, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet miratimi i ndarjes së parcelës kadastrale në Çikatovë e Re, me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e ndërtimit të objektit për persona me aftësi të kufizuar (prapambetje mendore).

Neni 2

Parcela që kërkohet të ndahet, është si më poshtë:

- Parcela kadastrale Nr.326-4 me sip.42991 m² zona kadastrale Shtrubullojë, propozohet që të bëhet ndarja e kësaj parcele kadastrale, ku prej sipërfaqes së përgjithshme të ndahet sipërfaqja S=2500 m².

Neni 3

Qëllimi i ndarjes së parcelës kadastrale 326-4 në z.k.Çikatovë e Re, bëhet për t'i hapur rrugë ndërtimit të objektit për persona me aftësi të kufizuar (prapambetje mendore).

Neni 4


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 5

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës


Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L – 048 ,Komuna e Drenasit obligohet të miratoj këtë propozim- vendim, me qëllim të ndërtimit të shtëpisë së komunitetit për persona me aftësi të kufizuar (SHKPAK), në Zonën Kadastrale Çikatovë e Re, kërkohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale 326-4 si më poshtë:

Për të realizuar ndërtimit të objektit për persona me aftësi të kufizuar (prapambetje mendore), në zonën kadastrale Çiaktovë e Re, nevojitet një sipërfaqe prej 2500 m², prandaj edhe do të bëhet ndarja e parcelës 326-4, ku nga sipërfaqe e përgjithshme e kësaj parcela do të ndahet sipërfaqja prej 2500 m².

Bashkangjitur i gjeni:

- Certifikatën mbi të drejtat e pronësisë
- Kopjen e planit dhe
- Skicën e propozuar për ndarje.
- Buxhetin e ndara për këtë investim

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		21/06/2024	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	400101-	29450	

Komisioni për Ndryshim dhe Plotësim të Statutit të Komunës

Bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 8 të Statutit të Komunës, Komisioni për plotësim dhe ndryshim të Statutit të Komunës, sa i përket riformulimin e emërimit dhe modifikimin e kompetencave dhe përgjegjësitë të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, vendimit me nr. 02-Nr.020/04-20699 të datës 29.04.2024 të Kryetarit të Komunës, më datën 20.06.2024, i propozon Kryetarit të Komunës, këtë:

PROPOZIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË DRENASIT

Neni 1

Duke u bazuar në nenin 8 të Statutit të Komunës, për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës, propozohet riformulimi i emërimit të Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe do të modifikohen kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij Drejtorati.

Neni 2

Ky riformulim i emërimit të Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe modifikimi i kompetencave dhe përgjegjësitë e këtij Drejtorati bëhet duke u bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 27.12.2023 në mes Komunës së Drenasit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Minsitrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 3

Në bazë të Memorandumit të lartëcekur, stafi i Pylltarisë transferohet nga Komuna në Agjencionin Pyjor të Kosovës, rojet e pyellit, teknikët e pylltarisë, përgjegjësve të njesive komunale, etj., bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet dhe pajisjet tjera tjera, si dhe mjetet përkatëse funksionale, që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshme pyjore.

Neni 4

Neni 85 i Statutit të Komunës: Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik, që lidhet me nenin 5 dhe 6 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës me nr. 12 Nr.030-19523 të datës 06.04.2018, riformulohet në "Drejtoratin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural", këtij drejtorati të riformuluar, të modifikuar i hjekën pikat 8, 13 dhe 15 që ka të bëjë me Sektorin e Pylltarisë dhe modifikohen pikat 1, 4, 5, 10, 11 dhe 14 të Drejtoratit të poshtëshenuar.

Neni 5

DREJTORATI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Ky Drejtorat:

1. Implementon Politikat zhvillimore në sektoret e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Koordinon dhe mbikëqyrë Asociacionet Bujqësore.
3. Përgatit planet për mbjelljet pranverore, vjeshtore dhe fushaten për korrije-shirje.
4. Organizon trajnime, këshillime për fermerët dhe panaire bujqësore.
5. Jep pelqim për rikultivimin e tokave Bujqësore, si dhe kthimin në destenimin fillestar.
6. Mban evidencen për tokat Bujqësore .
7. Bashkëpunim dhe përkrahjen e aktiviteteve rreth ujitjes në Kompaninë e “Iber Lepencit” .
8. Koordinon punët dhe bashkëvepron me OJQ-të që përkrahin aktivitetet Bujqësore .
9. Bashkëpunon me agjensionet qeveritare për zhvillimin e rajoneve rurale në kuadër të objektivave strategjike.
10. Planifikon zhvillimin dhe kujdesin permanent të shfrytëzimit të tokës Bujqësore për nevojat dhe interesat e Komunës, si dhe bën analiza lidhur me planet zhvillimore rurale.
11. Bashkëpunimi dhe koordinimi me Ministrinë e Bujqësisë , Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
12. Planifikimi i Zhvillimit Rural, subvencionimi i fermerëve dhe zbatimi I projekteve kapitale rurale.

A r s y e t i m

Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës, bazuar në autorizimet që i janë dhënë me vendimin e Kryetarit të komunës, ka bërë punën e tij duke marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për t’i inkorporuar në statutin ekzistues, te ndryshuar dhe plotësuar sa i përket këtij drejtorati, si dhe duke i inkorporuar në tekstin e ndryshuar dhe të plotësuar të nenit 85 të statutit të Komunës, që lidhet me nenin 5 dhe 6 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës me nr. 12 Nr.030-19523 te datës 06.04.2018, riformulohet në “Drejtoratin për Bujqësi, dhe Zhvillim Rural” dhe modifikimin lidhur kompetencat dhe përgjegjësitë te këtij Drejtorati.

Duke marr në konsideratë vërejtjet eventuale apo sugjerimet për ndryshime dhe plotësime të këtij propozim-plotësim ndryshim të nenit 85 të Statutit të Komunës, që lidhet me nenin 5 dhe 6 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës me nr. 12 Nr.030-19523 te datës 06.04.2018, propozojmë që këto ndryshime të dërgohen në shqyrtim fillestar në Kuvendin e Komunës.

Ky ndryshim dhe plotësim i Statutit ka ardhur si shkak i Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 27.12.2023 në mes Komunës së Drenasit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Minsitrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Pasi që ka kalu Ligji për Pyjet në Kuvend për bartjen e kompetencave në nivel qendror, dhe Memorandumit të nënshkruar nga Kryetari dhe Ministri, kemi kërkuar që të bëhet plotësim ndryshimi i Statutit dhe të hiqen detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Pylltarisë në Komunën e Drenasit.

KOMISIONI:

1. Bekim Morina
2. Shqipe Hoxha
3. Fatmir Baliu
4. Arbër Halilaj
5. Egzona Tërdevci
6. Hamit Kastrati
7. Azemine Bujupi Gjoka



Drenas,

Me datë 20.06.2024.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Glllogoc
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-463/06-45494 dt. 13.09.2024

Në bazë të nenit 58, pika h të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit, 72 pika h e Statutit të Komunës së Glllogocit, në bazë të nenit 5,6,7,14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 5 paragrafi 1.3 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe Vendimit të Listës së Veçantë të pronave të paluajshme të Komunës së Drenasit, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë gjatë vitit 2024 Nr.01-463/02-57111 dt.22.11.2023, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë _____,2024, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Glllogocit të miratoj Propozim Vendimin për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik.

Neni 2

Prona e paluajtshme të propozuara për dhënie në shfrytëzim të cekur si në pikën 1 të këtij Propozim Vendimi është:

1. Për shfrytëzim afatgjatë (për 99 vite)

Zona Kadastrale Glllobar

- Ngastra kadastrale nr.438/4, me sip.2559 m²
- Ngastra kadastrale nr.438/5, me sip.1838 m²
- Ngastra kadastrale nr.12/0, me sip.2794 m²
- Ngastra kadastrale nr.6//0, me sip.15000 m²
- Ngastra kadastrale nr.13-0 me sip.8454 m²
- Ngastra kadastrale nr.81-0 me sip.4000 m²
- Ngastra kadastrale nr.41-0 me sip.16500 m²

Zona Kadastrale Çikatovë e Re

-Ngastra kadastrale nr.140-3, me sip.19244 m²

-Ngastra kadastrale nr.126-2, me sip.2000 m²

Zona Kadastrale Glllogoc

-Ngastra Kadastrale nr.1032/2, me sip.5661 m²

-Ngastra Kadastrale 878-5, me sip.4259 m²

-Ngastra Kadastrale 758-1, me sip.1852 m²

-Ngastra Kadastrale 743-30, me sip.8510 m²

-Ngastra Kadastrale 768-1, me sip.1970 m²

-Ngastra Kadastrale 245-0, me sip.5000 m²

Zona Kadastrale Komoran

-Ngastra kadastrale nr.4/124, me sip.6963 m²

-Ngastra kadastrale nr.244/4, me sip.1863 m²

-Ngastra kadastrale nr.244/5, me sip.1547 m²

-Ngastra kadastrale nr.1980/0, me sip.2003 m²

-Ngastar kadastrale nr.1981/0, me sip.3263 m²

-Ngastra kadastrale nr.4-133 me sip.1059 m²

- Ngastra kadastrale nr.382-0 me sip.358246 m²

- Ngastra kadastrale nr.311-1 me sip.75318 m²

- Ngastra kadastrale nr.4-133 me sip.1059 m²

Zona Kadastrale Tërstenik

- Ngastra kadastrale nr.1963-0 me sip.103309 m²

Zona Kadastrale Korroticë e Poshtme

-Ngastra Kadastrale 716-2, me sip.8003 m²

-Ngastra Kadastrale 504 -0, me sip.2265 m²

Zona Kadastrale Korroticë e Epërme

-Ngastra Kadastrale 34-0, me sip.8128 m²

-Ngastra Kadastrale 208-1, me sip.13447 m²



Zona Kadastrale Fushticë e Epërme

-Ngastra Kadastrale 77-1, me sip.727119 m²

Zona Kadastrale Arllat

-Ngastra Kadastrale 2652-4, me sip 3232 m²

-Ngastra Kadastrale 2529-3, me sip.10082 m²

-Ngastra Kadastrale 276-0, me sip.2303 m²

-Ngastra Kadastrale 2360 -0, me sip.23446 m²

Zona Kadastrale Polluzhë

-Ngastra Kadastrale 144 -0, me sip.21241 m²

Zona Kadastrale Kishnarekë

-Ngastra Kadastrale 872 -2, me sip.366190 m²

-Ngastra Kadastrale 883-0, me sip.74447 m²

-Ngastra Kadastrale 885 -0, me sip.3346 m²

-Ngastra Kadastrale 886 -0, me sip.3322 m²

Zona Kadastrale Gllanasellë

-Ngastra Kadastrale 331 -0, me sip.142958 m²

-Ngastra Kadastrale 19 -0, me sip.179047 m²

Zona Kadastrale Sankoc

-Ngastra Kadastrale 295 -6, me sip.50000 m²

-Ngastra Kadastrale 295 -7, me sip.400000 m²

-Ngastra Kadastrale 295 -19, me sip.2972645 m²

-Ngastra Kadastrale 295 -17, me sip.39565 m²

Zona Kadastrale Likoshan

-Ngastra Kadastrale 556 -0, me sip.90000 m²

-Ngastra Kadastrale 568 -0, me sip.75310 m²

-Ngastra Kadastrale 573 -0, me sip.62399 m²

-Ngastra Kadastrale 572 -0, me sip.53389 m²

-Ngastra Kadastrale 575 -0, me sip.137655 m²



Zona Kadastrale Krajkovë

-Ngastra Kadastrale 913 -0, me sip.92000 m²

-Ngastra Kadastrale 848 -0, me sip.130000 m²

Zona Kadastrale Llapushnik

-Ngastra Kadastrale 999 -0, me sip.67275 m²

Zona Kadastrale Negroc

-Ngastra Kadastrale 559 -0, me sip.28119 m²

-Ngastra Kadastrale 539 -0, me sip.109084 m²

-Ngastra Kadastrale 1195 -0, me sip.18821 m²

Zona Kadastrale Abri e Epërme

-Ngastra Kadastrale 2048 -0, me sip.61902 m²

-Ngastra Kadastrale 1817 -1, me sip.70000 m²

Zona Kadastrale Domanek

-Ngastra Kadastrale 349- 0, me sip.74500 m²

Të gjitha këto ngastra kadastrale janë pronë e Kuvendit të Komunës së Drenasit/Gllogocit.

Neni 3

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhë afatgjate, do të bëhet përmes procesit të Konkursit publik për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe procedurave të parapara me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.


Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së dhe pas publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



ARSYETIM

Duke u bazuar në nenet 5,6,7,14 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në bazë të nenit 5 paragrafi 1.3 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe Vendimit të Listës së Veçantë të pronave të paluajshme të Komunës së Drenasit, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë gjatë vitit 2024 Nr.01-463/02-57111 dt.22.11.2023 kërkesat e personave fizik dhe juridik të cilët shprehin interesin për marrje në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës, me qëllim për investime në fusha të ndryshme të ekonomisë, janë propozuar disa prona komunale për dhënien në shfrytëzim.

Komisioni Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës duke u bazuar në faktin së me dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës do të krijohen kushte për zhvillim të bizneseve, krijimin e mundësisë për investime nga investitorët vendor dhe të huaj me ç'rast do të krijohën vende të reja të punës, dhe do të ndikohet në rritjen e zhvillimit ekonomik në Komunë, dakordohet dhe i propozon Kuvendit të miraton këtë Propozim Vendim.Me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sipas dispozitave ligjore në fuqi, Komuna do të inkason edhe të hyra komunale të cilat konsiderohen para publike dhe i nënshtrohen dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike.

Bashkangjitur me këtë propozim gjeni: vendimin për shpalljen e Listës së Përgjithshme të Pronave të Komunës së Drenasit, si dhe Listen e Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shrytëzim afatgjatë në vitin 2024, dhe paraqitjen tabelare të listës së veçant të pronave të paluajtshme të Komunës së Drenasit, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim afatgjatë gjatë vitit 2024.

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		19 106/2024	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
10-030101-29068			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna Drenas
Opstina Drenas – Municipality of Drenas
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



DRAFT - STRATEGJIA
PËR ZHVILLIMIN DHE FUQIZIMIN E RINISË
NË KOMUNËN E DRENASIT
2024-2029

Qershor 2024

STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN DHE FUQIZIMIN E RINISË NË KOMUNËN E DRENASIT 2024-2029

Dokumenti “Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Drenasit 2024-2029” është miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit, bazuar në vendimin me numrin e protokollit: / të datës __/____.

Dokumenti “Strategjia për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në komunën e Drenasit 2024-2029” është pjesë e projektit “Angazhimi i të Rinjve, një Zë për Ndikim”, i financuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së përmes programit “Alumni Engagement Innovation Fund 2023”, mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë, administruar nga KUSA dhe zbatuar nga dy anëtarë të Alumni, Laureta Thaqi dhe Xhemile Murati-Shabani, në komunat, Drenas dhe Ferizaj në bashkëpunim me organizatën Qendra për Avokim dhe Angazhim Qytetarë AdVOICE.

Ky dokument strategjik është përgatitur nga një grup pune i themeluar sipas vendimit 01-030/01-15523 të datës 28.03.2024 nga Kryetari i komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci¹. Grupi punues është i përbërë nga anëtarë si: Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, Handikos, OJQ, përfaqësues nga Këshilli i Nxënësve dhe Këshilli i Prindërve, dhe përfaqësues institucional. Qendrim Hoxha është angazhuar si konsulent këshillues, dhe hartues i Strategjisë.

¹ <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/category/vendimet/> (Lista e Akteve të Kryetarit të Komunës për Muajin Mars 2024)

Përmbajtja

Lista e Akronimeve	4
Fjala e Kryetarit të Komunës	5
1. Hyrje	6
2. Baza Ligjore.....	8
3. Metodologjia	9
4. Qëllimi i Strategjisë	10
5. Sfidat Aktuale të të Rinjve të Drenasit.....	11
6. Vlerësimi i Nevojave.....	13
7. Vizioni dhe politikat e DKRS—së.....	14
8. Objektivat.....	15
9. Monitorimi dhe Vlerësimi.....	22
10. Miratimi dhe Zbatimi	22
11. Komunikimi dhe Angazhimi i Vazhdueshëm	23
12. Plani i Veprimit.....	23

LISTA E AKRONIMEVE

KD - Komuna e Drenasit

KKG - Kuvendi i Komunës së Drenasit

KPF - Komiteti për Politikë dhe Financa

KAKRS - Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

DKRS - Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DKA - Drejtoria Komunale për Arsim

DSHMS - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

KVRL - Këshilli i Veprimit Rinor Lokal

MKRS - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

OJQ - Organizatat Jo-Qeveritare

SShR - Strategjia Shtetërore për Rininë

QRK - Qeveria e Republikës së Kosovës

M&V - Monitorimi dhe Vlerësimi

Fjala e Kryetarit Ramiz Lladrovci

“Strategjia për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në komunën e Drenasit 2024-2029”, sjell vizionin e qartë për të rinjtë e komunës sonë.

Ky vizion përfshin ndërtimin e kulturës së gjithëpërfshirjes, ku të rinjtë janë të angazhuar aktivisht në proceset zhvillimore dhe vendimmarrëse. Qëllimi është që të rinjtë të kenë mundësi të sjellin kreativitet dhe të ndikojnë me ide të reja në përparimin jo vetëm komunës si institucion, por edhe shoqërinë në përgjithësi.

Nëpërmjet kësaj strategjie, në mënyrë të saktë dhe gjithëpërfshirëse, bëhet vlerësimi i nevojave në kuadër të strategjisë për të rinjtë, sfidat, mundësitë dhe prioritetet e tyre. Ky proces është jetik për zhvillimin dhe përmirësimin e jetës së të rinjve në komunën e Drenasit.

Ky dokument strategjik është në harmoni të plotë me Strategjinë Shtetërore për Rininë 2024-2032, në përputhje me përkufizimin e të rinjve të përdorur në Strategjinë Evropiane për Rininë 2019-2027.

“Strategjia për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në komunën e Drenasit 2024-2029” është pjesë e projektit “Angazhimi i të Rinjve, një Zë për Ndikim”, i financuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së përmes programit “Alumni Engagement Innovation Fund 2023”, mbështetur nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë, administruar nga KUSA dhe zbatuar nga dy anëtarë të Alumni, Laureta Thaqi dhe Xhemile Murati-Shabani, në komunat, Drenas dhe Ferizaj në bashkëpunim me Organizatën Qendra për Avokim dhe Angazhim Qytetarë AdVOICE.

Bashkangjitur me Strategjinë, është edhe Plani i Veprimit për realizim të objektivave të Strategjisë dhe arritjen e përmirësimit të politikave të sektorit të rinisë për të rinjtë e Drenasit duke u bazuar në buxhetin e DKRS-së.

E përgëzoj dhe falënderoj Grupin Punues për strategjinë, donatorët dhe të rinjtë, të cilët i kontribuan hartimit të kësaj Strategjie sa të rëndësishme aq të domosdoshme për të rinjtë tanë.

Faleminderit, suksese!

1. HYRJE

Territori i Komunës së Drenasit zë një vend në pjesën qendrore të Kosovës. Kjo komunë përmban një sipërfaqe totale prej 290 km², që përfaqëson 2.66% të territorit të përgjithshëm të Kosovës. Rajoni përbëhet nga 42 vendbanime dhe është i rrethuar nga Malet e Berishës, Kasmaqit, Qyqavicës, Goleshit dhe Lipovicës (Blinajës), të cilat formojnë kufijtë natyrorë përgjatë Luginës së lumit Drenica. Lugina e Drenicës karakterizohet nga toka e pëlleshme që përfshihet nga sistemi i ujitjes "Ibër". Një element dallues tjetër i kësaj zone është prania e minierës dhe shkëmbimit të "Feronikelit", si dhe disa gurore. Përveç kësaj, përmes komunës kalojnë lumët Drenica dhe Vërbicë, ujërat e të cilëve përdoren për ujitjen e tokave bujqësore.

Nga perspektiva e lidhjeve tokësore, komuna është e lidhur me pjesët tjera të Kosovës përmes hekurudhës Fushë Kosovë-Pejë dhe rrugës magjistrale Prishtinë- Komoran-Pejë, si dhe rrugëve ndërkommunale Shalë-Lipjan dhe Komoran-Drenas-Skënderaj. "Sipas regjistrimeve të popullsisë të realizuar në vitin 2011, rezulton që numri i popullsisë në Komunën e Drenasit ka qenë 58,531 banorë, nga të cilët 29728 i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 28803 gjinisë femërore."²

Në komunën e Drenasit janë 42 vendbanime: 36 fshatra, dy qendra urbane, tre lokalitete dhe qendra e Drenasit. Komuna është e banuar ekskluzivisht nga shqiptarët.

Komuna u themelua para Luftës së Dytë Botërore si një njësi e veçantë sociale, politike dhe administrative. Gjatë tetëdhjetë viteve të fundit, zhvillimi ekonomik ka qenë në nivele shumë të ulëta, për shkak të politikave të mëparshme antipopullore që ndoqën një qasje diskriminuese, veçanërisht në fushën ekonomike. Megjithatë, kjo komunë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt transformimit të ngadaltë por progresiv të strukturave të saj ekonomike, bujqësore, arsimore, shëndetësore dhe industriale. Përmirësimi i strukturës së zhvillimit komunal ka qenë i ndikuar kryesisht nga ndërtimi i rrjetit arsimor-edukativ, zgjerimi i shërbimeve shëndetësore dhe intensifikimi i zhvillimit bujqësor, veçanërisht pas ndërtimit të sistemit të ujitjes "Ibër-Lepenc". Ndërtimi i kompleksit "Feronikelit" ka shënuar një lëvizje pozitive në ekonominë e pazhvilluar të Drenasit.

² Të dhënat nga <https://ask.rks-gov.net/PopulationStats/PopulationByRegion>

Drenasi është identifikuar gjatë viteve si një qytet me një rini aktive dhe të suksesshme. Prandaj, strategjia për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Drenasit do të përgatitet me qëllimin e kontributit të vazhdueshëm në këto komponente, duke mbajtur të rinjtë si fokus kryesor.

Kjo strategji do të përfshijë një sërë veprimesh që synojnë të adresojnë nevojat dhe potencialet e të rinjve në aspekte të ndryshme të jetës së tyre. Ato përfshijnë arsimin, punësimin, pjesëmarrjen në vendimmarrje, shëndetin, kulturën dhe sportin, si dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të komunës së Drenasit. Strategjia paraqet një dokument planifikimi dhe orientimi që synon të përcaktojë nevojat, sfidat dhe mundësitë me të cilat përballen të rinjtë në Komunën e Drenasit. Ajo ndërmerr një qasje të qartë dhe të koordinuar për të mbështetur zhvillimin e tyre në dimensione të ndryshme të jetës, dhe është thelbësore për të siguruar që të rinjtë, të cilët përbëjnë një segment të rëndësishëm të popullsisë, të jenë të angazhuar, të fuqizuar dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të komunës sonë.

Disa nga aspektet kyçe që do të përfshihen në strategji janë:

- Zhvillimi i arsimit jo-formal dhe aftësive,
- Forcimi i komponentës së vullnetarizmit,
- Teknologjia, inovacioni dhe ndërmarrësia rinore,
- Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje dhe në politikat lokale,
- Mirëqenia, shëndeti mendor dhe siguria e të rinjve,
- Kultura, arti, sporti dhe aktiviteti fizik,
- Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i ekonomisë së gjelbërt,
- Mbështetja për të rinjtë me aftësi të kufizuara,
- Mbështetja për të rinjtë nga grupet e tjera të marginalizuara

Ky dokument strategjik është në harmoni të plotë me Strategjinë Shtetërore për Rininë 2024-2032. Kjo strategji shtetërore zotohet të ofrojë të rinjve kosovarë një platformë për realizimin e të drejtave dhe potencialeve të tyre, përmes masave politike dhe veprimeve të planifikuara. Strategjia synon të ofrojë mundësi dhe përvoja që mbështesin integrimin e të rinjve në shoqëri dhe fuqizimin e tyre si agentë të zhvillimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Me termin "të rinj", kjo strategji, sikurse edhe Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032, nënkupton të gjithë

personat nga moshë 15 deri në 29 vjeç, e cila është grupmosha që synohet nga kjo strategji. Ky term është parashikuar edhe në draft-ligjin për Rininë dhe është në përputhje me përkufizimin e të rinjve të përdorur në Strategjinë Evropiane për Rininë 2019-2027³.

2. BAZA LIGJORE

Për përgatitjen e strategjisë për fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve të Komunës së Drenasit, ne kemi marrë parasysh dhe konsultuar bazat ligjore specifike të legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe të Komunës së Drenasit. Informacionet ligjore janë shqyrtuar për të siguruar një mbështetje adekuate në hartimin e një strategjie efektive. Dokumentacioni i marrë si referencë përfshinë:

- Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale⁴;
- Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative⁵;
- Statutin e Komunës së Drenasit⁶;
- Udhëzimin Administrativ (QRK) nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit⁷;
- Manualin për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Tyre të Veprimit⁸;
- Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032⁹.

Si grup punues, kemi theksuar rëndësinë e një baze ligjore të qartë dhe të plotë, e cila do të shërbejë si udhërrëfyes gjatë gjithë procesit të hartimit të strategjisë dhe deri në miratimin e saj. Për këtë qëllim, kemi konsultuar edhe Zyrtarët Ligjor të Komunës së Drenasit për të vlerësuar nëse dokumentacioni i përzgjedhur është i përshtatshëm dhe relevant për nevojat e grupit punues dhe të procesit në tërësi.

³ https://youth.europa.eu/strategy_en

⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

⁶ <https://kk.rks-gov.net/glogoc/wp-content/uploads/sites/10/2017/10/Statuti-i-Komunes.pdf>

⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18813>

⁸ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/MANUAL-PER-PLANIFIKIMIN-HARTIMIN-DHE-MONITORIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-TE-TYRE-TE-VEPRIMIT.pdf>

⁹ https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/STRATEGJIA_SHTETERORE_PER_RINI_2024-2032_SQ.pdf

Është thelbësore që gjatë hartimit të strategjisë për fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve të Drenasit të konsultohemi ngushtë me legjislacionin ekzistues që adreson fushën e rinisë dhe çështjet administrative që lidhen me zbatimin e kësaj strategjie. Kjo përfshirje e gjithanshme dhe e menduar mirë e legjislacionit garanton që strategjia të jetë jo vetëm e zbatueshme, por edhe e qëndrueshme në kohë.

3. METODOLOGJIA

Procesi i hartimit të Strategjisë për fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve në Komunën e Drenasit ka përfshirë një varg fazash të rëndësishme dhe të ndërthurura, duke filluar që nga formimi i ekipit drejtues deri te monitorimi dhe vlerësimi i implementimit të strategjisë.

Faza e parë, formimi i ekipit drejtues, u bazua në vendimin Nr.01-030/01-15523 të datës 28.03.2024 të Kryetarit të Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci. Grupi punues përfshin përfaqësues nga institucionet lokale, organizatat joqeveritare lokale, këshilli i nxënësve dhe ekspertë të fushave përkatëse për të drejtuar dhe koordinuar procesin në një mënyrë inkluzive.

Analiza e situatës aktuale dhe identifikimi i nevojave u realizuan nëpërmjet takimeve me grupe të ndryshme të interesit, ku u diskutuan sfidat dhe nevojat aktuale të rinisë në Drenas, duke siguruar një bazë të qartë të të dhënave për planifikimin e mëtejshëm.

Përfshirja dhe konsultimi me palët e interesit u trajtuan duke identifikuar dhe përfshirë organizata joqeveritare, komunitetet lokale dhe grupet e interesit, me qëllim që të gjitha perspektivat dhe nevojat të përfaqësohen efektivisht në strategji.

Përcaktimi i qëllimeve dhe prioritetëve strategjike është bërë mbi bazën e analizës së nevojave të të rinjve, duke u përqendruar në ofrimin e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe efektive që adresojnë këto nevoja dhe aspirata.

Zhvillimi i planit të hartimit të strategjisë përfshiu përcaktimin e objektivave specifike, masave të detajuara dhe përcaktimin e përgjegjësi dhe afateve kohore, duke u siguruar që strategjia të jetë e zbatueshme dhe efektive.

Mekanizmat e zbatimit dhe koordinimit janë projektuar për të garantuar që të gjitha institucionet dhe partnerët e përfshirë të jenë përgjegjës për realizimin e strategjisë dhe që burimet financiare të menaxhohen me transparencë dhe efikasitet.

Monitorimi dhe vlerësimi janë parashikuar të bëhen në mënyrë të rregullt dhe objektive, me qëllim që të monitorohet progresi dhe të identifikohen sfidat që kërkojnë përmirësim në strategjinë për rininë e Drenasit.

Miratimi dhe zbatimi i strategjisë do të bëhet në bazë të dokumentit përfundimtar të hartuar, duke përfshirë gjithashtu një pjesëmarrje të gjerë nga palët e interesit për të garantuar realizimin e qëllimeve strategjike.

Në fund, komunikimi dhe angazhimi i vazhdueshëm janë thelbësorë për të mbajtur të informuar dhe të angazhuar të rinjtë dhe të gjitha palët e interesit gjatë gjithë procesit të zbatimit të strategjisë, duke siguruar një përfshirje aktive dhe të vazhdueshme në zhvillimet e ardhshme në komunën e Drenasit.

4. QËLLIMI I STRATEGJISË

Qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të kontribuojë në fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve në Komunën e Drenasit. Dokumenti ka për qëllim të ofrojë mundësi trajnimi dhe zhvillimi personal për të rinjtë, duke i përgatitur ata të bëhen qytetarë aktiv dhe produktiv në shoqëri.

Në këtë kontekst, strategjia përcakton disa qëllime specifike:

- **Teknologjia, Inovacioni dhe Ndërmarrësia Rinore:** Zhvillimi i aftësive të të rinjve për t'i përgatitur ata për tregun e punës, duke ndihmuar në avancimin e tyre profesional në fusha të ndryshme.
- **Pjesëmarrja e të Rinjve në Vendimmarrje dhe Politikë Lokale:** Forcimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe lokale për të rritur ndikimin dhe praninë e tyre në zhvillimin komunitar.
- **Mirëqenia, Shëndeti Mendor dhe Siguria e të Rinjve:** Promovimi i një jete të shëndetshme dhe sigurimi i a në shërbime të mirëqenies për të rinjtë, duke përfshirë mbështetjen për shëndetin mendor dhe fizik.
- **Barazia dhe Gjithëpërfshirja:** Garantimi që të gjithë të rinjtë, pavarësisht nga sfondi ose aftësia, janë të përfshirë në mënyrë të barabartë në jetën sociale dhe politike të komunitetit.

Kjo përfshin mbështetje të veçantë për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera të marginalizuara.

- **Zhvillimi i Komponentës së Vullnetarizmit:** Inkurajimi i të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete vullnetare, duke kontribuar në mirëqenien dhe përmirësimin e komunitetit.
- **Kultura, Arti, Sporti dhe Aktiviteti Fizik:** Stimulimi i pjesëmarrjes së të rinjve në sporte, aktivitete fizike, dhe fushat e artit dhe kulturës, duke përfshirë edhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.
- **Mbrojtja e Mjedisit dhe Promovimi i Ekonomisë së Gjelbërt:** Mbështetja e iniciativave që nxisin ekonominë e gjelbërt dhe mbrojtjen e mjedisit, duke promovuar praktika të qëndrueshme dhe mjedise të pastërta.

Nëpërmjet këtyre qëllimeve, strategjia synon të angazhojë të rinjtë si **avokat/aktor** aktiv në zhvillimin dhe përmirësimin e komunitetit të tyre. Angazhimi dhe pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, si dhe ofrimi i mundësive për zhvillimin e tyre personal dhe profesional, janë jetike për realizimin e qëllimeve të strategjisë. Fokusimi në përfshirjen e të rinjve me aftësi të kufizuara është veçanërisht i rëndësishëm për të garantuar një shoqëri më gjithëpërfshirëse.

5. SFIDAT AKTUALE TË TË RINJVE TË DRENASIT

Të rinjtë e Drenasit, si në shumë komuna të tjera në Kosovë, përballen me një gamë të sfidave të ndryshme që ndikojnë në zhvillimin e tyre personal, profesional dhe social. Këto sfida, ndonëse të ndryshme në natyrë, shpesh kanë rrënjë të përbashkëta me ato të hasura në shumë vende të tjera, duke përfshirë mungesën e mundësive për punësim në profesione sipas përgatitjes profesionale, çështjet e shëndetit mendor, mungesa e gjithëpërfshirjes, mungesa e aktivitetit rekreativ-sportiv, sfidat e integritetit social dhe politik dhe ndikimin e përdorimit të tepërt të teknologjisë.

5.1. Mungesa e mundësive për punësim sipas përgatitjes profesionale

Mundësia e punësimit sipas profileve apo përgatitjes profesionale mbetet një sfidë kryesore për të rinjtë në Drenas. Tregu i punës është i ngushtë, me mundësi të kufizuara dhe konkurrencë të lartë, duke i shtyrë të rinjtë të angazhohen në punë jo relevante me përgatitjen e tyre apo të kërkojnë mundësi jashtë vendit

5.2. Çështjet e shëndetit mendor dhe mirëqenies

Shëndeti mendor i të rinjve përballët me sfida të shumta, duke përfshirë stresin nga shkolla dhe presionet sociale, ndikimin e medias sociale, probleme familjare si konfliktet ose ndarjet, dhe çështje si depresioni dhe ankthi. Këto çështje janë të ndërlikuara dhe kërkojnë një mbështetje të qëndrueshme dhe të përshtatshme.

5.3. Mungesa e gjithpërfshirjes tek të rinjtë

Të rinjtë përjetojnë ndjenja të izolimit dhe përjashtimit për shkak të bullizmit, ndjenjave të pakënaqësisë me veten, dhe standardeve të paimagjinueshme të imazhit në media sociale. Krijimi i një ambienti të përkrahës dhe të pranueshëm është thelbësor për të adresuar këto probleme.

5.4. Mungesa e aktiviteteve rekreative dhe sportive

Teknologjia dhe video-lojërat zëvendësojnë kohën që do të ishte shpenzuar në aktivitete fizike. Mungesa e motivimit, kohës së lirë, dhe burimeve financiare e bëjnë më të vështirë për të rinjtë të angazhohen në sport dhe aktivitete rekreative.

5.5. Sfidat e integritetit social dhe politik

Përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse mbetet një sfidë, edhe pse ka përmirësime. Mungesa e platformave dhe mundësive për përfshirje aktive shpesh i lë të rinjtë jashtë diskutimeve dhe vendimeve që i prekin ata direkt.

5.6. Ndikimi i përdorimit të tepërt të teknologjisë

Përdorimi i tepruar i teknologjisë dhe rrjeteve sociale mund të çojë në izolim social, varësi dhe ndikime negative në shëndetin mendor, kështu duke kërkuar një balancim të kujdesshëm të ndikimeve pozitive dhe negative të teknologjisë.

Përballja me këto sfida kërkon angazhim të përbashkët nga qeveria, sektori privat, organizatat joqeveritare dhe komuniteti në përgjithësi. Është jetike që të adresohen këto sfida për të ndihmuar të rinjtë të zhvillohen në të gjitha aspektet e jetës së tyre. Kjo përfshirje do të ndërtojë një mjedis më të mirë për të ardhmen e tyre dhe do të sigurojë një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

6. VLERËSIMI I NEVOJAVE

Vlerësimi i nevojave në kuadër të strategjisë për të rinjtë ka për qëllim të identifikojë dhe përshkruajë në mënyrë të plotë dhe të qartë nevojat e të rinjve, duke përfshirë sfidat, mundësitë dhe prioritete të tyre. Ky proces është jetik për zhvillimin e një strategjie efektive që synon të përmirësojë jetën e të rinjve në Drenas.

Nevojat kryesore që janë identifikuar nga të rinjtë e Drenasit përfshijnë:

1. Mbështetje për punësim në profesione sipas përgatitjes profesionale për të rinjtë, duke përmirësuar shanset e tyre në tregun e punës.
2. Promovimi i shëndetit mendor përmes edukimit shëndetësor dhe programeve mbështetëse.
3. Promovimi i barazisë dhe gjithpërfshirjes si vlera thelbësore shoqërore.
4. Inkurajimi i sportit dhe aktivitetit fizik si një stil i shëndetshëm jetese.
5. Mbështetje për integrimin social dhe politik të të rinjve në proceset vendimmarrëse.
6. Sensibilizimi i të rinjve për përdorimin e duhur të teknologjisë për të minimizuar ndikimet negative.
7. Organizimi i kampanjave vetëdijësuese kundër sjelljeve të rrezikshme si dhuna, droga, duhani, alkooli, etj., dhe promovimi i një stili jetese të shëndetshëm.
8. Edukimi për shëndetin seksual dhe riprodhues, duke ofruar informacion të saktë dhe të qartë.
9. Krijimi i mundësive për punë praktike dhe vullnetare në institucione komunale, organizata dhe kompani private.
10. Fuqizimi i të rinjve nga zonat rurale dhe grupet e marginalizuara për të përmirësuar përfshirjen e tyre shoqërore.
11. Zgjerimi i mundësive për edukim jo-formal, duke u ofruar të rinjve më shumë opsione për mësim dhe zhvillim.
12. Sigurimi i hapësirave dhe objekteve rinore të përshtatshme që mund të përdoren pa pagesë nga të rinjtë.
13. Përmirësimi i qasjes në infrastrukturën sportive dhe kulturore të komunës, duke e bërë atë më të lehtë dhe pa pagesë për të rinjtë.
14. Qasja në dokumentet publike dhe zyrtare dhe ngritja e llogaridhënies së institucioneve lokale për të rritur transparencën.

15. Mundësi më të mëdha për të rinjtë për të marrë pjesë në programe rinore të shkëmbimeve të përvojave, edukimit dhe praktikave të mira në nivel nacional, regjional dhe ndërkombëtar.

Ky vlerësim i nevojave shërben si bazë për zhvillimin e strategjive dhe politikave që adresojnë çështjet specifike dhe urgjente të cilat i prekin të rinjtë në Drenas, duke synuar krijimin e një mjedisi më mbështetës dhe të përfshirë për të gjithë.

7. VIZIONI DHE POLITIKAT E DKRS-SË PËR RININË

Komuna e Drenasit ndjek një vizion të qartë për të krijuar një mjedis ku të rinjtë mund të shpalosin plotësisht potencialin e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit. Vizioni përfshin ndërtimin e një kulture të gjithëpërfshirjes, ku të rinjtë janë të angazhuar aktivisht në proceset zhvillimore dhe vendimmarrëse. Qëllimi është që të rinjtë të kenë mundësi të sjellin inovacione dhe të ndikojnë me ide të reja në përparimin jo vetëm komunës si institucion, por edhe shoqërinë në përgjithësi. Kjo përfshirje e thellë synon të krijojë një komunitet më të fortë, më të barabartë dhe më prosperues për të gjithë anëtarët e tij. Politikat për rini veçanërisht të Sektorit të Rinisë në Komunën e Drenasit, janë si vijon:

1. Promovimi i Vullnetarizmit:

Sektori i Rinisë promovon dhe inkurajon angazhimin vullnetar të të rinjve në aktivitete dhe projekte të ndryshme që kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit.

2. Integrimi i grupeve të marginalizuara:

Veprimet dhe projektet e Sektorit të Rinisë synojnë të sigurojnë përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve nga grupet e marginalizuara për të garantuar barazinë dhe diversitetin në komunitet.

3. Fuqizimi i Organizatave Rinore:

Sektori i Rinisë ofron seminare, trajnime, dhe kurse për aftësimin e të rinjve dhe për të fuqizuar organizatat rinore në komunat e Drenasit.

4. Edukimi jo-formal:

Stimulimi i të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete edukative jo-formale që i ndihmojnë ata në zhvillimin personal dhe profesional.

5. Infrastruktura Rinore:

Investimo në infrastrukturën rinore për të krijuar hapësira dhe mundësi për aktivitete dhe projekte të rinisë në komunën e Drenasit.

Sektori i rinisë bashkëpunon me Departamentin e Rinisë pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, organizatat vendore dhe ndërkombëtare për të realizuar projekte dhe aktivitete të ndryshme sipas nevojave të të rinjve. Dokumentet e rëndësishme të Sektorit të Rinisë përfshijnë Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, Udhëzimet Administrative për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, edukimin jo-formal të të rinjve e udhëzime të tjera që rregullojnë politikën e rinisë. Këto dokumente udhëzojnë dhe rregullojnë aktivitetet dhe funksionimin e rinisë në komunat e Drenasit.

8. OBJEKTIVAT

Strategjia përcakton objektivat si strategjik dhe objektivat specifike që synojnë realizimin e vizionit dhe misionit të komunës së Drenasit. Këto objektiva janë të dizajnuara për të adresuar nevojat e të rinjve të identifikuar në vlerësimin e mëparshëm dhe për të siguruar një zhvillim të gjithanshëm të rinisë në aspektet sociale, profesionale dhe personale.

Objektivi Strategjik: Komuna e Drenasit synon të mbështesë zhvillimin e të rinjve në të gjitha sferat e jetës, duke përmirësuar mundësitë e punësimit sipas profileve, duke shtuar pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet kulturore, sportive, dhe sociale, dhe duke ndërtuar një kulturë të fuqishme të përfshirjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe zhvillimore.

OBJEKTIVA SPECIFIKE 1: Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre në profesione të ndryshme.

Aktivitetet e parapara për realizimin e objektivës përfshijnë:

1.1 Krijimi i programeve të trajnimit dhe edukimit: Hartimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit dhe edukimit që ofrojnë njohuri dhe aftësi praktike në fusha të ndryshme profesionale, duke përfshirë sesione trajnimi për kompetencat e nevojshme në tregun e punës. Këto programe do të fokusohen në përforcimin e njohurive teknike dhe praktike që janë të nevojshme për suksesin në fushat përkatëse.

1.2 Ofrimi i mundësive të praktikës dhe punësimit: Identifikimi dhe krijimi i mundësive për praktika dhe punësim për të rinjtë në institucione, kompani dhe organizata. Ky aktivitet synon të ndërtojë ura ndërmjet të rinjve dhe tregut të punës, duke përfshirë lidhjet me industrinë dhe rrjetet e kontakteve profesionale për të lehtësuar hyrjen në punësim.

1.3 Mentorimi dhe këshillimi individual: Sigurimi i mbështetjes së personalizuar dhe këshillimit për të rinjtë, duke ndihmuar ata në hartimin e programeve të tyre të karrierës dhe identifikimin e mundësive për zhvillim profesional. Kjo përfshin orientimin e tyre drejt zgjedhjeve të duhura akademike dhe profesionale që përputhen me interesat dhe aftësitë e tyre.

1.4 Organizimi i ngjarjeve dhe punëtorive: Organizimi i ngjarjeve dhe punëtorive të ndryshme që janë të orientuara drejt tregut të punës, si seminare dhe takime me punëdhënës potencial përmes panairove të karrierës dhe sesioneve informuese me profesionistë të fushave të ndryshme. Këto aktivitete synojnë të zgjerojnë rrjetin profesional të të rinjve dhe të ofrojnë njohje të drejtpërdrejtë me mundësitë e punësimit.

1.5 Zhvillimi i aftësive të buta: Përmirësimi i aftësive të buta të të rinjve, si komunikimi, menaxhimi i kohës, bashkëpunimi dhe negociatat. Këto aftësi janë thelbësore për suksesin në çdo ambient pune dhe ndihmojnë në përshtatjen e të rinjve me kulturën organizative.

1.6 Përgatitja për kërkimin e punës: Ofrimi i mbështetjes për të rinjtë në përgatitjen e materialeve të aplikimit për punë, si CV-të dhe letrat motivuese, dhe në përgatitjen për intervista pune. Kjo gjithashtu përfshin ndihmën në kërkimin e mundësive të punës nëpërmjet platformave të specializuara dhe rrjeteve profesionale, duke i pajisur me mjetet e duhura për të naviguar tregun e punës me sukses.

OBJEKTIVA SPECIFIKE 2: Përf forcimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe proceset lokale.

Aktivitetet e parapara për realizimin e objektivës janë:

2.1. Krijimi i platformave dhe forumeve: Organizimi i takimeve, forumeve dhe aktiviteteve të hapura për të rinjtë në nivel lokal për të shkëmbyer ide, të shprehin pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në diskutime për çështje që e prekin komunitetin. Këto platforma do të jenë hapësira inkurajuese ku të rinjtë mund të ndihen të dëgjuar dhe të ndikojnë në vendimet që i prekin ata dhe komunitetin e tyre.

2.2. Inkurajimi i përfaqësimit të të rinjve në institucionet vendore: Inkurajimi dhe mbështetja e të rinjve për të marrë pjesë në organet vendimmarrëse dhe grupet këshillimore, duke përfshirë këshillat lokale, OJQ-të rinore, kulturën dhe sportin, si dhe grupet jo formale dhe strukturat e tjera

vendimmarrëse. Kjo përfshin ndërtimin e kapaciteteve dhe ofrimin e burimeve që të rinjtë të mund të marrin pjesë efektivisht në procese.

2.3. Ofrimi i trajnimeve dhe aftësive për angazhimin civil: Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve që ofrojnë aftësi për të rinjtë për të marrë pjesë në aktivizmin social dhe të angazhohen në proceset demokratike dhe qytetare. Këto trajnime do të përfshijnë edukimin mbi të drejtat dhe përgjegjësitë qytetare, si dhe teknikat e ndikimit dhe lobimit.

2.4. Bashkëpunimi me organizatat rinore dhe shoqërinë civile: Krijimi i partneriteteve me organizata rinore dhe shoqërinë civile për të organizuar evente, projekte dhe fushata që inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje dhe proceset lokale. Këto partneritete do të ndihmojnë në zgjerimin e rrjetit të mbështetjes dhe në shkëmbimin e resurseve dhe njohurive.

2.5. Përdorimi i teknologjisë dhe mediave sociale: Efektivizimi i përdorimit të teknologjisë dhe mediave sociale për të komunikuar dhe mobilizuar të rinjtë për të marrë pjesë në diskutimet dhe proceset vendimmarrëse. Kjo përfshin zhvillimin dhe përdorimin e platformatave të mediave sociale dhe aplikacioneve të dedikuara për të lehtësuar komunikimin dhe pjesëmarrjen aktive.

2.6. Krijimi i politikave dhe strukturave që inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve: Përpilimi dhe zbatimi i politikave lokale që inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje dhe proceset qytetare. Kjo do të përfshijë politikat që krijojnë kuota për të rinjtë në organet vendimmarrëse dhe në forumet këshillimore, si dhe ndërtimin e një forumi të rinisë që funksionon si një platformë e pavarur për të artikuluar çështje dhe propozime nga të rinjtë.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE 3: Promovimi i një stili jetese të shëndetshëm dhe ofrimi i shërbimeve për mirëqenie të të rinjve.

Aktivitetet e parapara për realizimin e objektivit:

3.1. Organizimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit: Zhvillimi dhe implementimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit që promovojnë një stil jetese të shëndetshëm, duke përfshirë informacionin në lidhje me ushqimin e shëndetshëm, aktivitetin fizik, gjumin e mirë, dhe menaxhimin e stresit.

3.2. Ofrimi i këshillimit individual dhe ndihmës së personave në nevojë: Sigurimi i këshillimit individual dhe ndihmës për të rinjtë për të mbajtur një stil jetese të shëndetshëm, duke përfshirë ndihmën për të përcaktuar qëllime personale të mirëqenies dhe strategji për t'i arritur ato.

3.3. Organizimi i aktiviteteve fizike dhe rekreativo-sportive: Organizimi i aktiviteteve fizike dhe sportive të ndryshme, duke përfshirë turne sportive, gara, ligjerime, ushtrimi dhe programe sportive të përhershme që inkurajojnë të rinjtë për të qëndruar aktiv.

3.4. Përdorimi i teknologjisë për promovimin e shëndetit: Zhvillimi dhe përdorimi i aplikacioneve dhe platformave digjitale që inkurajojnë dhe ndihmojnë të rinjtë për të monitoruar dhe përmirësuar shëndetin e tyre, duke përfshirë aplikacione për trajnime ushtrimi dhe për të monitoruar konsumin e ushqimit.

3.5. Promovimi i shërbimeve shëndetësore të specializuara: Promovimi i shërbimeve shëndetësore të specializuara për të rinjtë, duke përfshirë promovimin e shërbimeve psikologjike, kujdesin për shëndetin seksual dhe riprodhues, dhe kujdesin për probleme të veçanta shëndetësore.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE 4: Sigurimi i barazisë dhe pjesëmarrjes së të gjithë të rinjve në jetën sociale dhe politike të komunitetit. Këtu rekomandohet mbështetja për të rinjtë me aftësi të kufizuara, mbështetja për të rinjtë e grupeve të tjera të marginalizuara.

Aktivitetet e parapara për realizimin e objektivit:

4.1. Krijimi i ambienteve gjithpërfshirëse: Krijimi i ambienteve gjithpërfshirëse dhe të mbështetura në shkolla, institucione publike dhe komunitete që inkurajojnë pjesëmarrjen dhe kontributin e të gjithë të rinjve, duke përfshirë përmirësimin e qasjes për të rinjtë me aftësi të kufizuara.

4.2. Ndërtimi i partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile: Bashkëpunimi dhe partneritetet me organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e të rinjve të grupeve të tjera të marginalizuara, duke përfshirë organizatat që punojnë me të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë me gjendje të rënduar sociale-ekonomike dhe të rinjtë me përvoja të ndryshme shoqërore dhe kulturore.

4.3. Ofrimi i trajnimeve dhe fushatave informuese: Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve informuese për të rinjtë për të drejtat e tyre, proceset politike dhe mënyrat për të marrë pjesë në jetën sociale dhe politike të komunitetit.

4.4. Inkurajimi i përfaqësimit të diversitetit në institucionet vendore: Inkurajimi dhe mbështetja e përfaqësimit të diversitetit në mekanizmat shoqëror dhe institucional dhe grupet këshillimore, duke siguruar që të rinjtë nga komunitetet e ndryshme dhe grupet e marginalizuara të kenë zë në proceset vendimmarrëse.

4.5. Ofrimi i këshillimit: Sigurimi i këshillimit për të rinjtë që kanë nevojë për mbështetje të veçantë për të marrë pjesë në jetën sociale dhe politike të komunitetit, duke përfshirë të rinjtë me aftësi të kufizuara.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE 5: Inkurajimi i të rinjve për të angazhuar në punë vullnetare për të kontribuar në mirëqenien e komunitetit.

Aktivitetet e parapara për realizimin e objektivit:

5.1. Promovimi i ndërgjegjësimit dhe motivimit: Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe motivimit për të rinjtë, duke përfshirë sesione informuese, takime të grupeve rinore dhe prezantime të projekteve vullnetare që kanë një impakt pozitiv në komunitet.

5.2. Identifikimi i nevojave të komunitetit dhe të projekteve vullnetare: Identifikimi i nevojave konkrete të komunitetit dhe identifikimi i projekteve vullnetare të cilat mund të adresojnë ato nevoja në mënyrë efektive dhe efikase.

5.3. Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve vullnetare: Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve vullnetare të ndryshme, duke përfshirë punë nëpër ambientet e mjedisit, ndihmë në komunitet, vizita në shtëpitë e të moshuarve dhe aktivitete të tjera që kontribuojnë në mirëqenien e komunitetit.

5.4. Krijimi i platformave vullnetare: Krijimi i platformave për të rinjtë për të identifikuar dhe marrë pjesë në projekte vullnetare, duke përfshirë platformat dixhitale, faqet e internetit dhe aplikacionet mobile.

5.5. Ofrimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme: Ofrimi i trajnimeve dhe aftësive të nevojshme për të rinjtë për të qenë të suksesshëm në punën vullnetare, duke përfshirë aftësitë e komunikimit, menaxhimin e kohës dhe bashkëpunimin në grup.

5.6. Inkurajimi dhe vlerësimi i kontributit vullnetar: Inkurajimi dhe vlerësimi i kontributit vullnetar të të rinjve, duke përfshirë rikonfirmimin e tyre për përpjekjet dhe impaktin e tyre në komunitet përmes ceremonive si ajo për shpalljen e vullnetarit të vitit.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE 6: Inkurajimi i të rinjve për të angazhuar në aktivitete fizike dhe sportive, por edhe nga arti, kultura dhe trashëgimia kulturore.

Aktivitetet e parapara për realizimin e objektivit:

6.1. Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve rekreativo-sportive: Organizimi i turneve, garave dhe aktiviteteve sportive të ndryshme për të rinjtë, duke përfshirë futbollin, basketbollin, volejbolin dhe sporte të tjera popullore, sidomos atyre që përfshijnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara.

6.2. Ofrimi i programeve dhe kurseve artistike dhe kulturore: Organizimi i programeve dhe kurseve për të rinjtë në fusha të artit, muzikës, teatrit, vallëzimit, artizanatit dhe trashëgimisë kulturore, duke përfshirë punëtoritë kreative dhe vizitat studimore.

6.3. Krijimi i ambienteve të mbështetëse për aktivitetet alternative: Sigurimi i hapësirave dhe burimeve për të rinjtë për të eksploruar dhe zhvilluar interesat e tyre në aktivitete alternative si ekskursione natyrore, udhëtime dhe studime kulturore.

6.4. Organizimi i eventeve kulturore dhe festivaleve rinore: Organizimi i eventeve kulturore, festivaleve rinore dhe ngjarjeve komunitare që promovojnë diversitetin kulturor dhe artistik dhe inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve në përmbajtje të ndryshme artistike dhe kulturore.

6.5. Përdorimi i teknologjisë për të inkurajuar pjesëmarrjen: Përdorimi i mediave sociale dhe teknologjisë për të promovuar dhe inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete fizike, sportive, artistike dhe kulturore, duke krijuar platforma dixhitale dhe aplikacione që inkurajojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE 7: Mbështetje e nismave që promovojnë ekonominë e gjelbërt dhe mjediset të pastërta dhe të gjelbra.

Aktivitetet e parapara për realizimin e objektivit:

7.1. Inkurajimi i nismave për energjinë e ripërtrishme: Mbështetja dhe promovimi i investimeve në projekte për energjinë e ripërtritshme.

7.2. Promovimi i transportit ekologjik: Inkurajimi i përdorimit të transportit publik, biçikletave, makinave elektrike dhe modaliteteve të transportit të qëndrueshëm në vend të makinave me gazra të ndotjes.

7.3. Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit: Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit për publikun në lidhje me rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit të burimeve të qëndrueshme, duke përfshirë programe të shkollave dhe aktivitete komunitare.

7.4. Inkurajimi i investimeve të qeverisjes lokale në projekte mjedisore: Mbështetja e politikave dhe nismave qeveritare që inkurajojnë investime të qeverisë dhe të rinjve në projekte mjedisore, duke përfshirë grante dhe politika të tjera mbështetëse.

7.6. Përdorimi i teknologjisë për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit: Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë aplikacione dixhitale për raportimin e ndotjes së mjedisit dhe platforma për mbledhjen e të dhënave mjedisore.

Duke përqendruar përpjekjet në këto hapa specifike dhe aktivitete të përcaktuara, qeverisja lokale, bizneset, organizatat jo-qeveritare, klubet sportive, grupet joformale dhe individët mund të ndihmojnë në realizimin e këtyre objektivave.

9. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi janë dy procese kyçe në zbatimin e strategjisë për rininë në Komunën e Drenasit. Për të siguruar suksesin dhe për të korrigjuar rrugëtimin sipas nevojave të aktualizuara, është e rëndësishme të monitorohen dhe vlerësohen aktivitetet dhe rezultatet në një mënyrë sistematike dhe objektive. Kjo përfshin përdorimin e indikatorëve të suksesit të përcaktuar më parë për të vlerësuar progresin dhe për të identifikuar sfidat dhe mundësitë për përmirësim.

Përveç monitorimit të progresit, një plan i vlerësimit do të përcaktojë metodologjitë dhe mjetet për të matur ndikimin dhe përceptimin e strategjisë nga palët e interesit. Përmes këtyre proceseve, strategjia për rininë në komunën e Drenasit është përshtatur në mënyrë efektive për të përmbushur synimet dhe qëllimet e saj.

Më poshtë po përmendim disa indikatorë të cilët janë matës të suksesit të strategjisë:

- Ritmi i rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete rinore
- Hapësira dhe përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse

Plani i vlerësimit: Zhvillimi i një plani për vlerësimin periodik të zbatimit të strategjisë dhe arritjes së objektivave. Bartësi, zbatuesi dhe implementuesi dhe mbikëqyrësi kryesor i kësaj strategjie do të jetë Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

10. MIRATIMI DHE ZBATIMI

Miratimi dhe zbatimi i strategjisë për rininë janë hapat kyç për të siguruar që synimet dhe objektivat e planifikuara të realizohen. Këta hapa do të konkretizohen përmes këtyre fazave:

- Përgatitja e dokumentit final të strategjisë;
- Prezantimi në debat publik dhe marrja e komenteve/sugjerimeve gjatë konsultimit publik;
- Prezantimi para Komitetit për Politikë dhe Financa;
- Prezantimi para Kuvendit të Komunës;
- Miratimi nga Kuvendi i Komunës së Drenasit

Kjo qasje e strukturuar dhe e qartë siguron jo vetëm miratimin dhe fillimin e zbatimit të strategjisë për rininë, por edhe përfshirjen e gjerë dhe monitorimin efektiv për të garantuar arritjen e objektivave të saj. Miratimi i strategjisë do të bëhet nga autoritetet përkatëse të komunës. Ndërmarrja e veprimeve për zbatimin e strategjisë do të bëhet duke u bazuar në planin e veprimit

i cili është në përputhje me qëllimin dhe objektivat e Strategjisë, dhe duke siguruar pjesëmarrjen e gjerë.

11. KOMUNIKIMI DHE ANGAZHIMI I VAZHUESHËM

Komunikimi dhe angazhimi i vazhdueshëm janë thelbësore për suksesin e strategjisë që synon të përfshijë dhe të mbështesë të rinjtë në komunën e Drenasit. Për këtë qëllim, kemi planifikuar që të zhvillohet dhe zbatohet një plan komunikimi që përfshin përdorimin e platformave dhe kanaleve të ndryshme mediale, si rrjetet sociale, uebfaqet zyrtare dhe media e tjera, për t'i mbajtur të informuar të rinjtë dhe palët e interesit rreth progresit, arritjeve dhe mundësive për pjesëmarrje.

Për të nxitur angazhimin e vazhdueshëm, strategjia gjithashtu do të përfshijë zhvillimin e programeve dhe aktiviteteve që mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe në zbatimin e projekteve. Kjo do të arrihet përmes organizimit të punëtorive, takimeve konsultative dhe platformave interaktive online ku të rinjtë mund të shprehin idetë dhe sugjerimet e tyre.

Rëndësia e kësaj përfshirjeje qëndron në krijimin e një ndjenje pronësie dhe përfshirjeje për të rinjtë, e cila është jetike për realizimin e qëllimeve të strategjisë dhe për të ndërtuar një komunitet më të përfshirë dhe të angazhuar.

SHTOJCË: PLANI I VEPRIMIT

Shtojcë e kësaj strategjie është Plan i Veprimit për realizim të objektivave të Strategjisë dhe arritjen e përmirësimit të politikave të sektorit të rinisë për të rinjtë e Drenasit duke u bazuar në buxhetin e DKRS-së, i cili është paraparë të mbështetet edhe me donatorë apo institucione të tjera që ofrojnë mbështetje për sektorin e rinisë. Në planin e veprimit janë përfshirë objektivat e strategjisë, aktivitetet për secilin objektiv, rezultatet e pritshme, institucioni përgjegjës për implementim dhe monitorim, institucionet partnere, afati kohor dhe kosto financiare që total është 394,650.00 €. Vlen të përmendet fakti që ky Plan i Veprimit parasheh mbështetjen financiare në vlerë maksimale sipas buxhetit të komunës për projekte të OJQ-ve lokale, mirëpo këto organizata rezervojnë të drejtën që të sigurojnë bashkëfinancim edhe nga institucionet e tjera qendrore dhe organizata ndërkombëtare për të realizuar projektet e tyre.

Objektivat:	Aktivitetet:	Rezultatet e pritshme	Institucioni përgjegjës	Institucionet partnere	Afati kohor			Buxheti
					2024	2025	2026	Totali
1. Përgatitja e të rinjve për tregun e punës dhe ndihma në zhvillimin e tyre në profesione të ndryshme	1.1 Krijimi i programeve të trajnimit dhe edukimit	Rritë aftësitë profesionale, përmirëson mundësitë e punësimit, nxitë inovacionin dhe kreativitetin, si dhe kontribuon në zhvillimin e tyre personal dhe profesional	DKRS/ Drejtoria për Arsimit/OJQ-ja përfituese	MKRS	300 €	300 €	300 €	900 €
	1.2 Ofrimi i mundësive të praktikës dhe punësimit	Rritja e mundësive për praktikë dhe punësim për të rinjtë në institucione, kompani dhe organizata	DKRS/DKA/Drejtoria për Zhvillim Ekonomik/OJQ/Zyra e Punësimit	Donoret; UNDP, GIZI, Ministritë Relevante	500€	500€	500€	1,500€
	1.3 Mentorimi dhe keshillimi individual	Mbështetje dhe keshillim për të rinjtë, duke ndihmuar ata në programe të karrierës dhe identifikimit të mundësive për	DKRS/Drejtoria për Arsimit/OJQ-ja përfituese	OJQ-të rinore	500 €	500 €	500 €	1,500€

1.4 Organizimi i ngjarjeve dhe punëtorive	Rritë aftësitë sociale, nxitë bashkëpunimin, dhe përmirëson aftësitë praktike dhe profesionale	DKRS/Drejtoria për Arsim/OJQ-ja përfutuese	OJQ	300 €	300 €	300 €	900 €	
	1.5 Zhvillimi i aftësive të buta	Rritë komunikimin, lidhshpin, punën në grup, zgjidhjen e problemeve dhe adaptueshmërinë, duke përmirësuar mundësitë e tyre për punësim dhe sukses	DKRS/ Drejtoria për Arsim/OJQ-ja përfutuese	OJQ-ja përfutuese, OJQ-të	600 €	600 €	600 €	1,800 €
		1.6 Përgatitja për kërkimin e punës	Rrit aftësitë e aplikimit, përmirëson intervistat, ndihmon në krijimin e CV-ve efektive dhe rritë shanset për punësim të suksesshëm	DKRS/Drejtoria për Arsim/OJQ-ja përfutuese /Zyra e Punësimit	OJQ-ja përfutuese, OJQ-të	500 €	500 €	500 €
2. Përforcimi i pjesëmarrjes aktive të të rinjve në vendimmarrje dhe proceset lokale	2.1 Krijimi i platformave dhe forumeve	Organizim i takimeve, forumeve dhe aktiviteteve për të rinjtë	DKRS/OJQ-ja përfutuese	OJQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500 €

<i>2.2 Inkurajimi i përfaqësimit të të rinjve në institucionet lokale</i>	Ndërtimi i kapaciteteve dhe ofrimi i burimeve që të rinjtë të mund të marrin pjesë efektivisht në procese vendimmarrëse	DKRS/OJQ-ja përfituese	OJQ-të	400 €	400 €	400€	1,200 €
<i>2.3 Ofrimi i trajnimeve dhe aftësive për angazhimin civil</i>	Rrit pjesëmarrjen aktive në komunitet, nxitë përgjegjësinë shoqërore, dhe përmirëson aftësitë e lidërsipit	DKRS/OJQ-ja përfituese	OJQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500 €
<i>2.4 Bashkëpunimi me organizatat rinore dhe shoqërinë civile</i>	Partneriteti i fuqishëm me Organizatat Rinore dhe shoqërinë civile përmes tryezave, eventeve etj.	DKRS/OJQ-ja përfituese	OJQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500 €
<i>2.5 Përdorimi i teknologjisë dhe mediave sociale</i>	Zhvillimi dhe përdorimi i platformave të mediave sociale dhe aplikacioneve me qëllim të lehtësimit të komunikimit dhe pjesëmarrjes aktive	DKRS/OJQ-ja përfituese/ Qendra e Inovacionit	OJQ-të	400 €	400 €	400 €	1,200€

<i>2.6 Krijimi i politikave dhe strukturave që inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve</i>	Krijimi i politikave dhe strukturave që inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve rrit angazhimin, nxit inovacionin, forcon zërin e tyre në vendimmarrje dhe përmirëson zhvillimin shoqëror dhe ekonomik	DKRS	OIQ-të	200 €	200€	200€	600 €
<i>3.1 Organizimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit</i>	Përmirëson njohuritë, ngritë ndërgjegjësimin shoqëror, promovon ndryshime pozitive dhe zhvillon mendimin kritik	DKRS/ DKA	OIQ-ja përfutese	200 €	200 €	200 €	600 €
3.Promovimi i një stili jetese të shëndetshëm dhe ofrimi i shërbyeve për mirëqenie të të rinjve	<i>3.2 Ofrimi i kështillimit individual dhe ndihmës së personave në nevojë</i>	DKRS/DKA/DSHMS	OIQ-të, MD, MSH, MKRS	2000 €	2000 €	2000 €	6000 €

3.3 Organizimi i aktiviteteve fizike dhe rekreativo-sportive	Përmirëson shëndetin fizik dhe mendor, nxitë bashkëpunimin dhe krijon komunitet, ngritë energjinë dhe mirëgenien	DKRS	OJQ-të, MKRS	1000 €	1000 €	1000 €	1000 €	3000€
3.4 Përdorimi i teknologjisë për promovimin e shëndetit:	Ngrit ndërgjegjësimin, ofron qasje të lehtë në informacion dhe ndihmon në menaxhimin efektiv të shëndetit	DKRS/DSHMS	MKRS, MSH, MD	1000 €	1000€	1000 €	1000 €	3000 €
3.5 Promovimi i shërbimeve shëndetësore të specializuara	Ngrit ndërgjegjësimin për zgjidhjet mjekësore të disponueshme, përmirëson qasjen për pacientët dhe rrit vetëdijën për mirëgenien dhe trajtimin e sëmundjeve komplekse	DKRS/DSHMS	MSH, MD	3000 €	3000 €	3000 €	3000 €	9000 €

4. Sigurimi i barazisë dhe pjesëmarrjes së të gjithë të rinjve në jetën sociale dhe publike të komunitetit	4.1 Krijimi i ambienteve gjithpërfshirëse	Përmirëson qasjen dhe përfshirjen e të gjithë individëve, pavarësisht prej ndryshimeve të tyre, dhe promovon një mjedis të përshatshëm për të gjithë përvojat dhe nevojat	DKRS/DKA	OIQ-të	700€	700€	700€	2,100€
	4.2 Ndërtimi i partnerieteve me organizatat e shoqërisë civile	Partneritet më i fuqishëm me organizatat të shoqërisë civile dhe mbështetja e tyre përmes subvencioneve, projekteve dhe bashkëpunimeve të tjera	DKRS	OIQ-ja përfuturse, Grupet Vullnetare, MKRS	800€	800€	800€	2,400 €
	4.3 Ofrimi i trajnimeve dhe fushatave informuese	Të rinjtë të informuar për të drejtat e tyre, proceset politike dhe metodat që sigurojnë të drejtat e tyre për të marr pjesë në jetën sociale dhe publike të komunitetit	DKRS/DKA	OIQ-të	600€	600€	600€	1,800€

4.4 Inkurajimi i përfaqësimit të diversitetit në institucionet vendore	Pritet të risë përfaqësimin e grupeve të marginalizuara, të përmirësojë përgjigjen ndaj nevojave të të gjithë qytetarëve, dhe të ndihmojë në zhvillimin e politikave dhe shërbimeve të përshatshme për të gjithë.	DKRS	OJQ-të	400€	400€	400€	400€	1,200€
5. Inkurajimi i të rinjve për të angazhuar në punë vullnetare për të kontribuar në mirëqenien e komunitetit	5.1 Promovimi i ndërgjegjësimit dhe motivimit	Ngrija e vetëdijes në temat e rëndësishme, nxijen e angazhimit dhe përmirësimit e performancës individuale dhe grupe	DKRS/OJQ përfituese	MKRS, MZHR, OJQ-të	300 €	300 €	300 €	900 €
5.2 Identifikimi i nevojave të komunitetit dhe të projekteve vullnetare:	Rrit efektivitetin e ndihmës, përmirëson jetën e komunitetit, nxit pjesëmarrjen aktive dhe zhvillon projekte të synuara dhe të qëndrueshme	DKRS/OJQ përfituese	MKRS, MZHR, OJQ-të	250 €	250 €	250 €	250 €	750 €

5.3 Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve vullnetare	Më shumë punë vullnetare në komunitet dhe rini aktive	DKRS/OIQ përfutuese	MKRS, MZHR, OIQ-të	250 €	250 €	250 €	750 €	
5.4 Krijimi i platformave vullnetare	Krijimi dhe gasja në platforma elektronike për të nxitur dhe promovuar punën vullnetare	DKRS/OIQ përfutuese	MKRS, MZHR, OIQ-të	700 €	700 €	700 €	750 €	
5.5 Ofrimi i njohurive dhe afërsive të nevojshme	Të rinjtë të informuar dhe trajnuar për punë vullnetare dhe bashkëpunimin në grup	DKRS/OIQ përfutuese	MKRS, MZHR, OIQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500 €	
5.6 Inkurajimi dhe vlerësimi i kontributit vullnetar	Shpallja e vullnetarit të vitit	DKRS/OIQ përfutuese	MKRS, MZHR, OIQ-të	300 €	300 €	300 €	900 €	
6. Inkurajimi i të rinjve për të angazhuar në aktivitete fizike dhe sportive, por edhe nga arti, kultura dhe trashëgimia kulturore	6.1 Organizimi i ngjarjeve dhe aktiviteteve rekreative-sportive	Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve të angazhuar në aktivitete fizike dhe sportive	DKRS/OIQ përfutuese	MKRS-OIQ-të	110.00 0 €	110.00 0 €	110,00 0 €	330,000 €

6.2 <i>Ofrimi i programeve dhe kurseve artistike dhe kulturore</i>	Organizimi dhe mbajtja e punëtorive kreative dhe vizitave studimore	DKRS/OIQ përfituese	MKRS/OIQ-të	1000 €	1000 €	1000 €	3000 €
6.3 <i>Krijimi i ambienteve të mbështetëse për aktivitetet alternative</i>	Rezultatet përshijnë rritjen e pjesëmarrjes në aktivitete të shëndetshme dhe kreative si arti, sporti, dhe aktivitetet shoqërore. Këto ambiente promovojnë shëndetin mendor dhe fizik, ndihmojnë në reduktimin e stresit dhe përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme të pjesëmarrësve.	DKRS	MKRS/OIQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500 €
6.4 <i>Organizimi i eventeve kulturore dhe festivalet rinore</i>	Të rinjtë të përfshirë në ngjarje kulturore e festivalet që promovojnë diversitetin kulturor e artistik	DKRS/OIQ përfituese	MKRS/OIQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500 €

7. Mbështetje e nismave që promovojnë ekonominë e gjelbër dhe mjediset të pastërta dhe të gjelbra	6.5 Përdorimi i teknologjisë për të inkurajuar pjesëmarrjen	Të rinjtë të inkurajuar për pjesëmarrje në aktivitete fizike, sportive, artistike e kulturore nga mediat sociale	DKRS/OIQ	MKRS/OIQ-të	300 €	300 €	300 €	900 €
	7.1 Inkurajimi i nismave për energjinë e ripërtirshme	Ngritë ndërgjegjësimin për ndikimin e mjedisit dhe promovon zhvillimin e teknologjive të qëndrueshme dhe të pastrueshme për mjedisin.	DKRS/OIQ	OIQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500 €
	7.2 Promovimi i transportit ekologjik	Përdorim më i shpeshtë transportit lokal, bicikletave e modalitete të tjera të transportit ekologjik	DKRS/OIQ-të	OIQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500€
	7.3 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit	Përshpejton ndryshimin e sjelljeve të komunitetit, ngritë vetëdijjen për çështjet mjedisore, dhe promovon ato	DKRS/OIQ-të	OIQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500 €

7.4 Inkurajimi i investimeve të qeverisjes lokale në projekte mjedisore	Përmirësohet infrastruktura mjedisore, zvogëlohet ndikimi negativ, dhe promovon përdorimin e burimeve të qëndrueshme	DKRS	OIQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500€
7.5 Përdorimi i teknologjisë për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit	Lehtëson identifikimin e rreziqeve ambientale, dhe ndihmon në zbatimin e masave të mbrojtjes së mjedisit.	DKRS/OIQ-të	OIQ-të	500 €	500 €	500 €	1,500 €
TOTALI							394,650.00 €



Republika e Kosovës



Komuna e Drenasit

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR 19/06/2024			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	070103-	29064	

Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSBB-së për gjashtëmujorin e parë 2024

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas udhëzimit administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat komunale për Siguri në Bashkësi, neni 9 Detyrat dhe Përgjegjësitë e kryesuesi të KKSBB-së, pika 1.8 është e obliguar të bëhet Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e KKSBB-së.

Duke u bazuar në këtë udhëzim administrativ, ju informoj se në fillim të vitit 2024 me qëllim të realizimit të detyrave operative lidhur me çështjet e Sigurisë në Bashkësi, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr.04/01-076, për Policinë, nenit 11, pika 2 e udhëzimit administrative nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për KKSBB-në, është caktuar orari i punës, ku janë paraparë gjashtë (6) takime të rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe Plani i Punës.

Duke u bazuar në nenin 11, pika 2, ku thuhet “KKSBB-ja mban më së paku gjashtë (6) mbledhje në vit, tri (3) prej se cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik dhe tri në gjashtëmujorin e dytë, Komuna e Drenasit i është përmbytur duke mbajtur tri mbledhje gjatë periudhës Janar-Qershor.

Në gjashtëmujorin e parë për të cilin po informojmë, janë mbajtur tri takime të cilat janë thirrur 7 ditë para mbajtjes së takimit dhe janë publikuar në ueb faqen e komunës së Drenasit. Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si siguria e ambientit, siguria shëndetësore, siguria rrugore dhe propozime të tjera që kanë dalë gjatë mbledhjeve nga anëtarët e KKSBB-së. Për tri mbledhjet e mëposhtme është hartuar procesverbal që është publikuar në ueb faqe, gjithashtu është dërguar edhe në MAPL, Divizioni për Siguri në Bashkësi.


Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKSBB-së dhe monitorues, ku zakonisht kanë qenë të pranishëm përfaqësues nga KFOR. Në tabelën e mëposhtme të përmbledhur gjëni takimet, temat dhe adresimi i tyre.

Data e Mbledhjes	Temat e diskutuara	Adresimi/Përgjegjësit
Mbledhja e parë: 18.01.2024 Linku: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/Ëp-content/uploads/sites/10/2024/01/Ftesa-e-pare-e-KKSB-se-per-vitin-2024.pdf	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 07.12.2023: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/Ëp-content/uploads/sites/10/2024/01/Procesverbali-i-mbledhjes-se-mbajtur-me-date-07.12.2023.pdf 2. Draft-Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2024; 3. Orari i mbajtjes së mbledhjeve të KKSB-së gjatë vitit 2024; 4. Raport vjetor i punës së KKSB-së gjatë vitit 2023; 5. Të ndryshme	Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët
Mbledhja e dytë: 18.04.2024 Linku: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/thirret-mbledhja-e-rregullt-e-kksb-se/	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.01.2024: https://kk.rks-gov.net/.../procesverbali-i-mbledhjes-se.../ 2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit; 3. Diskutim për migrimin në Drenas (Kërkesë për të dhëna nga MAPL); 4. Të ndryshme: Mobilizimi për pastrimin e mjedisit në Komunën e Drenasit.	Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët
Mbledhja e tretë: 14.06.2024 Linku: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ftesa-per-mbledhjen-e-kksb-se-per-daten-13-06-2024/	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.04.2024, https://kk.rks-gov.net/gllogoc/procesverbal-i-dates-18-prill-2024/; 2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit;	Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët

	3. Informim për fushatën “Bashkë për pastërtinë e komunës së Drenasit- zemrën e Kosovës; 4. Të ndryshme	
--	---	--

Përveç KKSB-së janë mbajtur Këshillat Lokal për Sigurinë Publike ashtu siç parashihet me udhëzim administrativ gjithsej 4 takime të kryesuara nga kryesuesi i KLSP-së. Në këto takime janë diskutuar tema që lidhen me sigurinë, me praninë edhe zyrtarëve policor. Një nga kërkesat që kanë dalë nga KLSP lidhur me krijimi e nënstacionit policor në Komoran, tashmë është në proces të realizimit. Ndërsa, edhe çështja e mobilizimit për pastrim është ngritur edhe përmes KKSB-së në mënyrë që të këtë mobilizim masiv dhe gjithëpërfshirje.



Kryetari i komunës

Ramiz Lladrovci

KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		29/08/2024	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	400/01-	42452	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opstina/Municipality Drenas (Gllogoc)
Zyra e Kryetarit



DRAFT
BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2025 DHE
DHE PROJEKSIONET PËR VITET 2026 - 2027

Drenas, gusht 2024

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 dhe 40 pika 40.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 61 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 34 pika 34.6 nën (b) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës, propozon:

DRAFT
BUXHETI I KOMUNËS PËR VITIN 2025 DHE PROJEKSIONET PËR VITET
2026- 2027

Neni 1

Më këtë Draftohet, Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2025 si dhe projektionet për vitet 2026- 2027.

Buxhetit për vitin 2025 miratohet në shumë prej: **22,133,550.00** euro, si dhe projektionet:

- Për vitin 2026 në shumë prej: **23,198,706.00** euro dhe
- Për vitin 2027 në shumë prej: **24,289,673.00** euro.

Neni 2

Të hyrat e Buxhetit të Komunës, planifikohen të realizohen nga dy burime:

- Grantet e Qeverisë dhe nga
- Të hyrat Vetanake .

Komuna gjatë viteve në vijim, mund të realizoi mjete nga donacionet dhe participimi i qytetarve dhe huamarrja. Mjetet nga donacionet, participimi dhe huamarrja, do të jenë pjesë të këtij buxheti dhe do ndikojnë në rritjen e buxhetit, varësisht nga viti që do të ndodhë. Rritja e buxhetit do të bëhet, vetëm kur mjetet të paguhet në zhirolllogarinë e Komunës.

Neni 3

Të hyrat e buxhetit të komunës planifikohet të realizohen si vijon:

Të hyrat sipas sektorve	Buxheti	Projeksionet	
	2025	2026	2027
Spektori i Administratës	9,439,381.00	9,988,255.00	10,547,138.00
Spektori i Arsimit	8,232,004.00	8,478,964.00	8,733,333.00
Spektori i Shëndetësisë	2,525,698.00	2,645,921.00	2,771,867.00
Projeksioni i të hyrave vetanake	1,936,467.00	2,085,565.00	2,237,335.00
Gjithsej të hyrat:	22,133,550.00	23,198,706.00	24,289,673.00

Neni 4

Shpenzimet për vitet 2025-2027 aprovohen për 20 programe – nënprograme buxhetore në nivel komunal, dhe në gjashtë (5) kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve dhe kolonën “Rezerva” (detyrimet kontigjente-sipas kërkesës së dale nga qarkorja 2025/2) si vijon:

Buxheti për vitin 2025

Programet:	Staf 2025	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Investime kapitale	Rezerva	Gjithsej:
Zyra kryetarit	21	199,948	111,272		25,000			336,220
D.Administratës	42	270,605	127,450			30,000		428,055
D.Inspekcionit	10	92,878	70,950					163,828
Zyra e Kuvendit	31	262,906	10,000					272,906
D.Buxh.e Financa	17	130,448	20,950					151,398
D.Sh.Pub.Inf.Rrug	26	214,885	452,208	190,000	110,000	105,000		1,072,093
D.Infrastr.Publike	9	66,378	52,000			5,520,103		5,638,481
Z.Kom. dhe Kthi.	1	10,060	600					10,660
D.Bujq.zh.rural	7	54,583	38,299		60,000			152,882
D.Gjeod.kad.pron	13	80,528	6,650					87,178
D.Plan.Urban	9	55,013	109,300			30,000		194,313
D.Zhvill ekonomik	8	56,300	41,930		20,000			118,230
D.Kulturë, Rini, sport	13	92,016	116,885		135,000	365,000		708,901
Admin Shendetësi	5	35,039	9,040		94,000			138,079
QKMF	205	1,953,306	507,696	54,000		223,819	10,696	2,749,517
QPS	14	116,422	45,080	9,200		230,000		400,702
Adm.Arsim	12	100,492	440,040		150,000			690,532
Arsimi parafillor	30	215,592	48,000	6,549				270,141
Arsimi fillor	735	5,834,739	320,000	65,000		468,018	78,253	6,766,010
Arsimi i Mesem	180	1,655,771	94,353	22,000			11,300	1,783,424
Gjithsej shpenz.	1388	11,497,909	2,622,703	346,749	594,000	6,971,940	100,249	22,133,550

Projeksioni për vitin 2026

Programet:	Staf	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Rezerva	Gjithsej:
Zyra kryetarit	21	210,615	116,450		10,000			337,065
D.Administratës	42	285,378	130,600			24,000		439,978
D.Inspekcionit	10	97,822	58,050					155,872
Zyra e Kuvendit	31	285,716	21,700					307,416
D.Buxh.e Financa	17	137,403	20,950					158,353
D.Sh.Pub.Inf.Rru	26	229,940	481,400	211,350	110,000	35,000		1,067,690
D.Infrastr.Publike	9	69,974	52,000			6,264,594		6,386,568
Z.Kom. dhe Kthi.	1	10,602	580					11,182
D.Bujq.zh.rural	7	57,952	49,099		75,000			182,051
D.Gjeod.kad.pron	13	85,324	6,650					91,974
D.Plan.Urban	9	58,406	109,300			40,000		207,706
D.Zhvill ekonomi	8	59,764	37,230		90,000			186,994
D.Kultur Rini spo	13	97,444	117,185		158,700	335,000		708,329
Admin Shendetësi	5	36,911	3,840		30,000			70,751
QKMF	205	2,048,385	526,150	60,062		206,800		2,841,397
QPS	14	122,756	40,580	9,200		200,000		372,536
Adm.Arsim	12	105,964	440,040		150,000			696,004
Arsimi parafillor	30	227,450	49,000	6,549				282,999
Arsimi fillor	735	6,155,650	320,000	65,000		290,000		6,830,650
Arsimi i Mesem	180	1,746,838	94,353	22,000				1,863,191
Gjithsej shpenz.	1388	12,130,294	2,675,157	374,161	623,700	7,395,394		23,198,706

Projeksioni për vitin 2027

Programet:	Staf	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione	Investime Kapitale	Rezerva	Gjithsej:
Z.Kryetarit	21	219,869	122,750		11,000			353,619
D.Administrate	42	299,964	130,000					429,964
D.Inspekcionit	10	102,038	52,950					154,988
Zyra Kuvendit	31	289,230	21,700					310,930
D.Buxh.financa	17	141,740	20,950					162,690
D.sh.Pub I.Rru	26	239,697	491,400	236,120	110,000	35,000		1,112,217
D.Inf.Publike	9	73,767	52,000			6,557,349		6,683,116
Z.Kom.Kthim	1	11,374	580					11,954
D.Bujq.zh.rur	7	61,084	54,798		82,984			198,866
D.Gj.Kad	13	89,962	6,500					96,462
D.Planif Urban	9	61,563	119,300			45,000		225,863
D.Zhv.Ekonomi	8	62,995	45,019		125,000			233,014
D.Kult.R.Spor	13	102,748	88,000		160,612	334,000		685,360
D.Ad.Shendet	5	38,886	3,840		34,000			76,726
QKMF	205	2,159,683	573,900	54,000		220,000		3,007,583
QPS	14	129,778	40,580	9,200		200,000		379,558
Adm.Ars	12	111,737	440,040		150,000			701,777
Arsimi Parafill	30	239,959	50,000	6,549				296,508
Arsimi Fillor	735	6,494,210	320,000	65,000		330,000		7,209,210
Arsimi Mesem	180	1,842,915	94,353	22,000				1,959,268
Gjithsej.shpenz	1388	12,773,199	2,728,660	392,869	673,596	7,721,349		24,289,673

Neni 5

Shpenzimet për Paga dhe Shtesa të përcaktuara më këtë draft do të shpenzohen për pagimin e stafit të tre sektorëve kryesor të komunës. Në programet dhe nënprogramet buxhetore janë lejuar të financohen **1388** punëtor dhe ky numër i financimit është i përcaktuar më Qarkorën Buxhetore 2025/02, lëshuar nga Ministri i Financave Punës dhe Transfereve.

Pagat e aprovuara të stafit më këtë vendim nuk mund të rriten gjatë vitit fiskal, me përjashtim të rritjes së lejuar me vendim të Qeverisë.

Neni 6

Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzimet Komunale për vitet 2025-2027, janë të planifikuara dhe aprovuara, sipas programeve-nënprogrameve buxhetore për plotësimin e nevojave gjatë viteve, por gjithnjë duke pasur parasysh mundësinë e kursimeve.

Neni 7

Mjetet e dedikuara për Subvencione dhe Transfere do të shpenzohen për projekte të ndryshme për të cilat programet dhe nënprogramet kanë paraqitë kërkesat e tyre, dhe do të shpenzohen në bazë të kriterëve të përcaktuara, dhe dispozitave ligjore dhe rregullave të përcaktuara nga Departamenti i thesarit –MFPT .

Neni 8

Shpenzimet për Investime Kapitale do të shpenzohen sipas projekteve të aprovuara nga Kuvendi i Komunës dhe Kuvendi i Kosovës dhe të regjistruara në programin e PIP-it.
Pjesë e këtij vendimi është edhe Lista e Projekteve Kapitale për tri vite (2025-2027).

Neni 9


Tek “Rezerva”, komuna ka ndarë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontigjente. Mjetet për ndarjen e buxhetit për detyrimet kontigjente, komuna i ka marrë brenda kufirit të ndarë buxhetor për komunat me qarkore buxhetore, duke përjashtuar nga kategoria e shpenzimeve Paga dhe Shtesa.

Neni 10

Buxheti i aprovuar për vitet 2025-2027 është bazuar në Qarkoret Buxhetore 2025/01 dhe atë 2025/02 për komunat lëshuar nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.

Neni 11

Ky vendim i buxhetit, hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdesën; Kryetari i Komunës si dhe Menaxheret e programeve –nën programeve- mbajtësit e buxhetit, ndërsa së aplikuari fillon nga 1 Janari 2025.


KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci



KOMUNA E DRENASIT
LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2025-2027




	10 - BKK	21 - THV	Financimi	Viti 2025	Vlerësuar për 2026	Vlerësuar për 2027	Totali	Financimi
611180- Shërbime Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia								
Infrastruktura Publike								
451 Rregullimi i shtritit të lumit Drenica dhe Verbica	15,000.00	-	-	15,000.00	20,000.00	50,000.00	85,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishtë	70,000.00	-	-	70,000.00	200,000.00	400,000.00	670,000.00	
451 Ndërtimi i rrugës bregut Oqavacës	5,000.00	-	-	5,000.00	60,000.00	300,000.00	365,000.00	
451 Ndërtimi i parkut dhe shfiteve për këmbësor, biçiklistë në parkun e Kamenicës Drenas	150,000.00	-	-	150,000.00	142,121.00	170,000.00	462,121.00	
451 Ndërtimi i kolektorve për gjumullimin e ujrave të zeza Drenas-Dobroshec	279,113.00	-	-	279,113.00	450,000.00	200,000.00	929,113.00	
451 Rregullimi rrotore dhe ndërtimi publik Drenas, Komoran, Arlat,	500,000.00	-	-	500,000.00	500,000.00	400,000.00	1,400,000.00	
451 Terstenik, Dobroshec dhe Baic.								
451 Asfaltimi i rrugës dhe kubizim në Drenas I,II,III dhe IV	300,000.00	-	-	300,000.00	500,000.00	350,000.00	1,150,000.00	
451 Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Fehmi e Xheva Lladrovci" Drenas	810,887.00	145,103.00	-	955,990.00	-	-	955,990.00	
451 Asfaltimi i rrugës në Komoran I,II,III dhe IV	100,000.00	-	-	100,000.00	174,000.00	200,000.00	474,000.00	
451 Ndërtimi i rumbinave dhe Mureve Mbrojtje Drenas, Komoran, Arlat,	80,000.00	-	-	80,000.00	149,000.00	300,000.00	529,000.00	
451 Terstenik, Dobroshec, Baic dhe Otkarov e Vjeter								
451 Ndërtimi, zgjerimi dhe Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuar në Drenas	600,000.00	-	-	600,000.00	600,000.00	677,349.00	1,877,349.00	
451 Ndërtimi, zgjerimi dhe Rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Drenas	350,000.00	-	-	350,000.00	189,000.00	200,000.00	739,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllanasselle Godane	50,000.00	-	-	50,000.00	280,000.00	150,000.00	480,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik I,II dhe Gllobar	65,000.00	-	-	65,000.00	100,000.00	100,000.00	265,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Terstenik I,II dhe Gllobar	80,000.00	-	-	80,000.00	80,000.00	150,000.00	310,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Abri Epërme,Terdeve	80,000.00	-	-	80,000.00	100,000.00	100,000.00	280,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec, Otkarov e Vjeter	80,000.00	-	-	80,000.00	212,545.00	250,000.00	542,545.00	
451 Asfaltimi i rrugës Baicë,Krajkovë,Danarek Shtrubullovë	90,000.00	-	-	90,000.00	140,000.00	200,000.00	430,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Nektoc, Kizharetë	80,000.00	-	-	80,000.00	140,000.00	200,000.00	420,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Gradie dhe Likoshan	50,000.00	-	-	50,000.00	150,000.00	150,000.00	350,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Arlat, Negroc, Gjergjice si dhe Bytyq	80,000.00	-	-	80,000.00	140,000.00	150,000.00	370,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc,Fushitë e Epërme dhe Ulet	30,000.00	50,000.00	-	80,000.00	140,000.00	100,000.00	320,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës Shituc Verboc dhe Polluzhe	70,000.00	-	-	70,000.00	150,000.00	100,000.00	320,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës fshat Llapushnik Potek-Vukove	100,000.00	-	-	100,000.00	140,000.00	150,000.00	390,000.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Gradie dhe Likoshan	80,000.00	-	-	80,000.00	208,907.00	200,000.00	488,907.00	
451 Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulet dhe Epërme,Korrotic e Ulet dhe Epërme	58,945.00	341,055.00	-	400,000.00	500,000.00	200,000.00	1,100,000.00	
451 Bashkëfinancim projektet me donator të jashtëm	50,000.00	-	-	50,000.00	119,000.00	240,000.00	409,000.00	
451 Ndërtimi i rrugës fshat Drenas	250,000.00	-	-	250,000.00	270,000.00	200,000.00	720,000.00	
451 Hapja e Kanaleve kulluese për gjatë rrugëve Drenas, Komoran, Arlat,	50,000.00	20,000.00	-	70,000.00	119,000.00	120,000.00	309,000.00	
451 Terstenik, Dobroshec dhe Baic.								
451 Ndërtimi i rrugës transit Drenas- Kroni I Mbretit	5,000.00	-	-	5,000.00	71,021.00	50,000.00	126,021.00	
451 Ndërtimi i rrugës për ujëmbledhës në fshatin Verboc	5,000.00	-	-	5,000.00	70,000.00	150,000.00	225,000.00	
451 Rehabilitimi i rrugës dhe ndërtimi i trotuarit Arlat-Negroc-Vucak	200,000.00	-	-	200,000.00	150,000.00	350,000.00	650,000.00	
451 Rregullimi i infrastrukurës në parkun e Pishave në Komoran-Fushitë	100,000.00	50,000.00	-	150,000.00	150,000.00	350,000.00	650,000.00	
Totali - Infrastruktura Publike	4,913,945.00	606,158.00	-	5,520,103.00	6,264,594.00	6,557,349.00	18,142,046.00	
611180 - Shërbime Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia								
Infrastruktura Rrugore								
451 Rregullimi dhe rrethimi i varrezave në Komunën e Drenasit dhe Komoran	50,000.00	-	-	50,000.00	20,000.00	20,000.00	90,000.00	
451 Zgjerimi i kamereve në Drenas dhe Komoran	-	10,000.00	-	10,000.00	5,000.00	5,000.00	20,000.00	
451 Zgjerimi dhe riparimi i trotuarëve dhe parkimeve në Drenas dhe Komoran	-	5,000.00	-	5,000.00	5,000.00	5,000.00	15,000.00	
451 Rregullimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre , Gjergjicë, Polluzhë, Terstenik, Arlat, Baicë	-	10,000.00	-	10,000.00	5,000.00	5,000.00	20,000.00	
451 Autocistern për zjarrfikës	30,000.00	-	-	30,000.00	-	-	30,000.00	

004

Totali-Infrastrukturë Rrugore				80,000.00	25,000.00	105,000.00	35,000.00	35,000.00	175,000.00
611850 - Kulturë, Rini, Sport									
Sherbimet Kulturore									
820	Ndërtimi i stadiomit të qytetit			320,000.00		320,000.00		320,000.00	960,000.00
820	Stadioni Sintetik Drenas				20,000.00	20,000.00		5,000.00	30,000.00
820	Fusha sportive				20,000.00	20,000.00		10,000.00	35,000.00
820	Blerja e librave					5,000.00		4,000.00	9,000.00
Totali - Kulturë, Rini, Sport				320,000.00	45,000.00	365,000.00	335,000.00	334,000.00	1,034,000.00
611920 - Arsimit dhe Shkencë									
Arsim fillor - Glllogoc									
980	Instalimi i nxënjeve qendrore: riparimi i kulmit në SHFMU-Xheladin Gashi-Plaku				80,000.00	80,000.00	20,000.00	20,000.00	120,000.00
980	Digitalizimi i shkollave (softëware dhe TIK)				100,000.00	100,000.00	50,000.00	50,000.00	200,000.00
980	Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut					-	50,000.00	50,000.00	100,000.00
980	Ndërtimi i aneksit të shkollës "Arif Shala" dhe aneksit të shkollës Naim Frashëri				160,000.00	160,000.00	50,000.00	70,000.00	280,000.00
980	Ndërtimi i kabineteve e klasëve për mesim terdior në shtim "H.B. F.G. J.G. SH.G. F&I. K. A.B. B.C. D.D. SH.P. R. K. SH.P"			76,881.00	51,137.00	128,018.00	40,000.00	10,000.00	178,018.00
980	Ndërtim i fushave të jashtme sportive dhe rrethjeve:GQ					-	30,000.00	30,000.00	60,000.00
980	Ndërtimi i aneksit ri në SHFMU "Rilindja"					-	-	-	-
980	Këndi i lojave dhe rekreacion në shkollë:THV					-	10,000.00	10,000.00	20,000.00
980	Ndërtimi i SHFMU"Rasim Kicina"në Drenas,paralet e ndarë në Shtrubullove					-	-	-	-
980	Ndërtimi i shkollës së re "Rasim Kicina"në Drenas					-	40,000.00	90,000.00	130,000.00
Totali - Arsimit dhe Shkencë				76,881.00	391,137.00	468,018.00	290,000.00	330,000.00	1,088,018.00
611730 - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale									
Sherbime shëndetësore primare									
721	Pajisje mjeksore mbi 1000€				123,819.00	123,819.00	106,800.00	120,000.00	350,619.00
721	Ndërtimi i QMF Arllat				50,000.00	50,000.00	100,000.00	100,000.00	250,000.00
721	Rrethojat e QMF - AMF				30,000.00	30,000.00			30,000.00
721	Regullimi i oboreve të QKMF QMF dhe AMF				20,000.00	20,000.00			20,000.00
Totali - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale				-	223,819.00	223,819.00	206,800.00	220,000.00	650,619.00
611755 - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale									
Sherbime rezidenciale									
1060	Ndërtimi i shtëpisë për komunitete- shërbime komunale për persona me aftësi të kufizuara			230,000.00		230,000.00	200,000.00	200,000.00	630,000.00
Totali - Sherbime sociale				230,000.00	-	230,000.00	200,000.00	200,000.00	630,000.00
611660 - Planifikimi Urban dhe Mjedisi									
Planifikim Urban dhe Inspektion									
620	Vendosja e sistemit të adresave, vendosja e tabelave dhe numrave ne Drenas, Komoran, Nekoc, Arllat, Baice, Terstenik dhe Dobroshec				5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	15,000.00
620	Gjellbriimi hapsirave publike ne territorin e Komunes se Drenasit				25,000.00	25,000.00	35,000.00	40,000.00	100,000.00
Totali - Planifikimi Urban dhe Mjedisi					30,000.00	30,000.00	40,000.00	45,000.00	115,000.00
611163 - Administratë dhe Personel									
Administrata									
133	Veturë zyrtare			25,000.00		25,000.00	24,000.00		49,000.00
133	Mobile			5,000.00		5,000.00			
Totali - Administrata				30,000.00	-	30,000.00	24,000.00	-	54,000.00

Glllogoc.me 28.08.2024



Buxhetimi gjinor 2025
Tabela 1: Numri I punëtorve

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2022	1325	604	721	3,945,460	4,754,540
2023	1327	603	724	3,953,280	4,746,720
2024	1368	625	743	4,419,232	5,252,976
Planifikimi për 2025	1388	645	743	5,828,623.00	5,669,286.00

Tabela 2: Planifikimi për vitin 2025 Nivlet e pagave
Emri I Institucionit: Komuna e Drenasit

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400	243	204	979,200.00	39	187,200.00
401-600	399	195	1,363,977.00	204	1,417,777.00
600+	746	321	3,281,577.00	425	4,268,178.00

Handwritten signature

Tabela 3. Numri I përfutuesve të subvencioneve nga komuna, apo edhe të shërbimeve të ofruara nga Emri I institucionit : Komuna e Drenasit

Viti	Buxheti total i shërbimit/su bveionit të caktuar	Numri total i përfutuesve	Numri i përfutuesve e gra	Numri i përfutuesve burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
	2022	370,000	708	310	398	107,820
	2023	420,000	508	172	336	142,212
	2024	493,000	445	176	269	196,110
	Planifikimi për 2025	594,000	594	256	338	256,000
						338,000


 Kryetari i Komunës
 Ramiz Lladrovci



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400/01-45496 Dt. 13/09/ 2024

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Neni 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 15, pika 8 të Ligjit Nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Kryetari i Komunës së Drenasit nxjerr:

PROPOZIM – VENDIM

Neni 1

Propozohet transferi i mjeteve financiare brenda Organizatës Buxhetore dhe kategorisë së Shpenzimeve Paga dhe Shtesa në shumën prej 140,227.00 euro.

Neni 2

Transferi i mjeteve bëhet nga nënprogramet:

Zyra e Kryetarit- 16001	31,068.00€
Administrata - 16301	6,901.00€
Zyra e Kuvendit Komunal- 16901.....	28,120.00€
Bujqësia- 47001.....	33,842.00€
Shërbimet Kadastrale- 65005.....	23,260.00€
Planifikimi Urbanizmi Inspekcioni- 66310.....	6,048.00€
Administrata- 73010.....	10,988.00€

Në nënprogramin:

Shërbime Publike, Infrastrukturë Rrugore.....140,227.00€

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.


KRYETARI I KOMUNËS
Hamiz Lladrovci

A r s y e t i m

Nga buxheti i planifikuar i Komunës së Drenasit në kategorinë ekonomike Paga dhe Shtesa për vitin 2024 janë ekzekutuar pagesa të vendimeve gjyqësore të cilat na e kanë vështirësuar ekzekutimin e pagave për muajt në vazhdim. Andaj, kërkohet të bëhet transfer I mjeteve brenda Organizatës Buxhetore nga ato nënprograme ku ka nënshpenzim tek nënprogrami ku kemi mbishpenzim në mënyrë që të bëhet harmonizimi I buxhetit në këtë kategori.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400/01-45499 Dt. 13/09/ 2024

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Neni 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 16, pika 8 paragrafi 8.3 të Ligjit Nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Kryetari i Komunës së Drenasit nxjerr:

PROPOZIM – VENDIM
Për ndryshimin e emrit të projekteve

Neni 1

Propozohet të ndryshohet emri i projektit kapital nga “Ndertimi i fushave te jashtme sportive dhe rrethojave G.Elshani Xh.Lladrovci dhe D.Drenices” me kod buxhetor 53691 në vlerë 50,000.00€ në:

“Ndertimi i fushave te jashtme sportive dhe rrethojave “D.Drenices, D.Fortesës, A. Bejta, Sh. Galica, G. Sylja dhe M. Gradica”.

Neni 2

Propozohet të ndryshohet emri i projektit kapital nga “Ndertimi i parkingjeve dhe pllatove Sh.galica,G.Sylja,7.Marsi,Xh.Lladrovci,H.Prishtina,dhe Sh.Polluzha” me kod buxhetor 53689 në vlerë 40,000.00€ në:

“Ndertimi i parkingjeve dhe pllatove G.Elshani, F. dhe I. Kastrati, A.Gashi, A.Shala, A.Bejta, Xh. Gashi, B.Curri, D. Drenices, L.Gurakuqi, Rilindja, A.Bujupi dhe 27 Korriku”

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.



KRYETARI I KOMUNËS
[Signature]
Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Gjatë vendosjes së projekteve të vitit 2023 në sistemin elektronik (PIP) është lëshuar një gabim teknik, ku janë përsëritur emrat e shkollave të vitit paraprak, ku projektet që janë cekur në PIP tashme janë të përfunduar.

Andaj, kërkojmë nga kuvendi që të aprovoj ndryshimin-përmirësimin e emrave të shkollave të siç është cekur në nenin 1 dhe 2 të këtij propozimi, pasi që projektet nga natyra dhe vlera nuk ndryshojnë dhe janë të rëndesishme të njëjtë.